VEHBI KADRIU

GJUHA SHQIPE

2

Vehbi KADRIU

Gjuha shqipe

Botues:
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
SË VERIUT Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, 1000 Shkup
Autor:
Vehbi KADRIU

Konceptoi strukturën e tekstit dhe u kujdes për zbërthimin didaktik:
Rita PETRO
Natasha PEPIVANI

Kryeredaktore:
Natasha PEPIVANI

Redaktore:
Ervisa PALOKA

Lektor:
Medina MEHMETI

Recensentë:
Ajten HAJDARI QAMILI
Arta SADIKU AKTESHI
Sabihare SEJFULLAI

Rregullimi grafik dhe teknik: Evgenija PAVLLOVA – ARS STUDIO

Kopertina:
Eva KUKALESHI

Ilustruese:
Ledia KOSTANDINI

Redaktor profesional:
Refail SULEJMANI

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2022

Me vendim për miratimin e tekstit mësimor në lëndën Gjuha shqipe për klasën 2 nr. 26-1465/1 të datës 18.10.2022 i miratuar nga Komisioni kombëtar i teksteve mësimore.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:811.18(075.2)

KADRIU, Vehbi
Gjuha shqipe 2 [Електронски извор] / Vehbi Kadriu ; [Ilustruese Ledia Kostandini]. - Shkup : Ministria për arsim dhe shkencë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2022

Начин на пристапување (URL):
https://e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Albanski_jazik_2.pdf. - Текст во PDF формат, содржи 150 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 18.11.2022

ISBN 978-608-273-165-0

COBISS.MK-ID 58667781

HYRJE

I/e dashur nxënës/e,

Teksti Gjuha shqipe 2 është shkruar për ty, që ti të mësosh të lexosh bukur, të shkruash drejt dhe pa gabime gjuhën shqipe, të flasësh për veten tënde dhe të tjerët, të mësosh përralla dhe histori të bukura nga vendi dhe nga bota, të kuptosh se çfarë ndodh në natyrë dhe në botën përreth. Në tekst, ti do të gjesh përgjigjet e pyetjeve për shumë gjëra që nuk i di, për shumë gjëra që të shqetësojnë apo që të japin kënaqësi.

Ti je personazhi kryesor i tekstit. Prandaj presim nga ti mendimet, vlerësimet, pyetjet dhe këshillat e tua të vlefshme.



PËRMBAJTJA

Përsëri në shkollë	8
Pushimet e verës	11
Kujtojmë alfabetin	12
Shkrimi i shkronjave a,m,i	13
Një faqe ditari	14
Shkrimi i shkronjave u, r, e	15
Vjershat e stërgjyshërve	16
Atdheu	17
Familja ime	18
Shkrimi i shkronjave ë, n, l, ll	19
Breshka dhe lepuri	20
Kujt i ngjan ti?	22
Shkrimi i shkronjave k, o, t, p	23
Media e shkruar dhe elektronike	24
Ninullat (këngët e gjumit)	26
Shkrimi i shkronjave s, h, sh	27
Nga fjalët te fjalia	28
Shkrimi i shkronjave b, j, f, nj	30
Fjalia me të cilën tregojmë	31
Shkronja e madhe dhe pika	32
Shkrimi i shkronjave d, dh, g, gj	33
Edhe mami punon	34
Përshkruaj mamin dhe babin	36
Shkrimi i shkronjave y, q, rr	37
Miqtë e mi të veçantë	38
Përshkruaj shokun dhe shoqen	39
Vizatuesja e vogël	40



PËRMBAJTJA

Fjalitë janë të ndryshme	42
Shkrimi i shkronjave c, v, ç	43
Trego një ngjarje	44
Shkrimi i shkronjave th, x, xh	45
Pyesim dhe përgjigjemi	46
Shkrimi i shkronjave z, zh	47
Dy shoqet	48
Si kuptohemi me të tjerët?	49
Fjalët e përshëndetjes	50
Pika dhe pikëpyetja	51
Vjeshta	52
Përshkruaj vjeshtën	54
Fjalia pohore dhe mohore	56
Libri	58
Pema e familjes	59
Dallojmë emrin	61
Alfabeti i shqipes	62
Ushtrime për emrin	64
Në fshat	65
Flasim për fshatin	67
Dallojmë emrat e njerëzve, të kafshëve...	68
Kush banon këtu pranë?	70
Profesione të dobishme e të bukura	72
Dallojmë emrat e vendeve	73
Letra e Babadimrit	74
Kartolina	76
Unë i dua kafshët	77

PËRMBAJTJA



Dallojmë mbiemrin	78
Këshilla për kafshët	80
Dallojmë përemrin. Përemrat vetorë	81
Gjashtë vëllezërit peshkatarë	82
Ai, ajo	86
Numërori	87
Në Teatrin e Kukullave	89
Përgatitemi për shfaqje	90
Numërori rendor	91
Ditë dimri	92
Dallojmë foljen	93
Përshkruaj dimrin	94
Ku e gjejmë ujin?	95
Uji është shumë i rëndësishëm	96
Përralla dhe filmi	97
Ushtrime për foljen	98
Pinoku mbjell monedha	100
Përshkruaj Pinokun	102
Princesha mbi bizele	103
Si ndërtohet përralla?	105
Kush jam unë	106
Unë jam, ti je...	107
A ke ndonjë sekret?	109
Piktura më e bukur	110
Nënës	111
Poezi për mamin dhe mësuesen	112
Para, tani, pas	113
Mësuesja e madhe Natyrë	114

PËRMBAJTJA



Gjinkalla dhe milingona	116
Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit	117
Krahasojmë kafshët e fabulave	119
Dje isha..., nesër do të jem...	120
Unë kam, ti ke...	121
Dje kisha. Nesër do të kem	123
Zhurmat e qytetit	125
Qyteti dhe rregullat	126
Të sigurt në rrugë	127
Kujdes sjelljet!	129
Unë lexoj... Ti shkruan... Ai pikturon	130
Vjersha e pyllit	131
Loli dhe trau i ekuilibrit	133
Në cirk	135
Faqja shkencore e revistës për fëmijë	136
Tekstet janë të ndryshme	137
Uji, ajri, toka, zjarri	138
Keci me veshë të mëdhenj	139
Veprimet e personazheve	141
Guri i Skënderbeut	142
Mësojmë për Skënderbeun - faqja shkencore	143
Festa e fëmijëve - Revista	144
Jemi vëllezër të një bote - Revista	145
Në cilin vend të botës jetoj unë? Dokumentari shkencor	146
A mund të ketë qytet të fëmijëve? - filmi	147
Ardhja e verës	148
Të gjithë me pushime	149
Mysafirët	150

Përsëri në shkollë

Mësuesja hyn e gëzuar në klasë. Ajo hap krahët sikur do t'i përqafojë të gjithë vogëlushët. Sa janë rritur ata!

–Tani do të më tregoni gjërat më të bukura që keni bërë gjatë pushimeve, – thotë ajo.

Unë jam Dreni. Këtë verë kam lexuar shumë libra. Libri që më pëlqeu më shumë, tregonte për njerëzit parahistorikë. Në kohën e lashtë fëmijët nuk shkonin në shkollë. Ata gjithë vitin e kishin pushim. Kam shkruar edhe një vjershë për ta. A doni t'jua tregoj?
Unë jam Klea. Gjatë pushimeve isha në fshat. Mësova të qëndroj mbi kalë. Në fillim kisha shumë frikë nga kali, por xhaxhai më ndihmoi të miqësohesha me të. Tani edhe unë mund të kalëroj. Mbase ndonjë ditë mund të marr pjesë në garat e vrapimit me kuaj.

Kupto tekstin

Mëso fjalë të reja

kohë e lashtë përdoret kur flitet për shumë e shumë kohë më parë;
njerëz parahistorikë quhen ata që jetonin në kohën e lashtë nëpër shpella.

Përgjigju pyetjeve

1. Cili prej nxënësve ishte me pushime në fshat? Çfarë kishte bërë atje?
2. Cili prej nxënësve nuk e ha spinaqin? Çfarë tregon tjetër ai?
3. Çfarë beson dhe çfarë nuk beson ti nga ato që tregon Alba?
4. Pse fëmijët parahistorikë nuk kishin nevojë të bënin pushime?
5. U lodhën apo u kënaqën nxënësit ditën e parë të shkollës? Pse?

Lexo vjershën që ka shkruar Dreni.

Sa me fat ishin fëmijët parahistorikë,
nuk bënin fare detyra shtëpie,
në shtrat shkonin me dhëmbët pa larë,
flinin e zgjoheshin fare pa orar,
nuk shkonin në shkollë, nuk bënin mësim,
dhe kështu, për ta, ishte gjithmonë pushim.

Plotëso dhe shkruaj

Krahaso veten me fëmijët parahistorikë. Shkruaj sipas modelit:

jetonin në shpella	jetoj në shtëpi
nuk bënin detyra shtëpie	bëj .....
hanin me duar	.....
nuk i lanin dhëmbët para se të flinin	.....
nuk shkonin në shkollë	.....
nuk kishin pushime verore	.....

Detyrë

Shkruaj nga një fjali për secilin nxënës: Andin, Klean, Albën dhe Drenin.

Pushimet e verës

1. Ku i kalove pushimet verore?
2. Cilat ishin lojërat më të bukura për ty?
3. A zure miq të rinj? Fol për ta.
4. Cilët ishin shokët apo shoqet e klasës që kujtoje më shpesh?
5. Ke lexuar libra gjatë pushimeve verore? Cilët?
6. Pushimet e verës njerëzit i kalojnë në vende të ndryshme, si:
   në mal, në det, në liqen.

● Shiko fotot e vendeve turistike. Vendos numrin në vendin e duhur (1. Parku i Mavrovës; 2. Plazhi i Durrësit; 3. Liqeni i Ohrit).

Detyrë

Ngjit në një fletë 3-4 foto nga pushimet e tua. Shkruaj poshtë tyre vendin dhe muajin kur ke dalë.

KUJTOJMË ALFABETIN

- **Lexo alfabetin**

A B C Ç D DH E Ë F G GJ H I
J K L LL M N NJ O P Q R RR S
SH T TH U V X XH Y Z ZH

1. Luani në klasë. Thoni alfabetin njëri pas tjetrit.

2. Gjej sa zanore dhe sa bashkëtingëllore kanë fjalët e mëposhtme:

shkolla	klasa	harta	stilolapsi	fletorja	banka	regjistri
z_ b_	z_ b	z_ b_	z_ b_	z_ b_	z_ b_	z_ b_

3. Ndaji në rrokje fjalët: *Borëbardha, Hajdi, Tarzani, Pinoku, Odiseja, Sirena.*

Bo-rë-bar-dha ....

....

4. Ndrysho shkronjën e parë dhe do të të dalë një fjalë tjetër:

qielli	**d**ielli
shumë	...umë
garë	....arë
lojë	...ojë
gisht	...isht
paqe	...aqe
arra	a...a
bora	...ora.

5. Plotëso fjalët me shkronjat e duhura dhe shkruaji në fletore.

Trëndafili i Anës kishte .....ashtë gje.....e.
Unë hëngra aku.....ore me .....tatë kupa.
.....anta e ....imit ë.....të e ku....e.
....uditërisht ....eli im fluturoi mbi ....ati.
Kok.....a e .....ushit ë.....të .....umbullake.
Në .....ungël ka .....umë kaf.....ë.
....do ditë ...eni im më zgjon nga ...umi
Pastaj u përplas në ....amin e dritares sime.

SHKRIMI I SHKRONJAVE A a, M m, I i

A

a

M

m

I

i

1. Lidh shkronjat e njëjta të shtypit me shkronjat e dorës.

A	m	M	a	l
m	A	I	M	a

NJË FAQE DITARI

- **Dëgjo me vëmendje një faqe nga ditari i një djali.**

18 shtator

I dashur ditar,

Ndihem pak i mërzitur. Pas disa ditësh do të fillojë shkolla. Të kuptohemi, unë e dua shkollën. Por më pëlqen më shumë të luaj. Nga ana tjetër, më vjen inat me të rriturit. Kur më takojnë, më thonë: "Dhe pak ditë pushim të kanë mbetur".

Unë mendoj se është më bukur të jesh i rritur, se nuk shkon në shkollë. Por babi më thotë se edhe puna është si shkollë.

Sot u kënaqa me gjyshin. Fola me të në skajp. Megjithëse është 65 vjeç, e përdor kompjuterin më mirë se unë. Ai e mësoi që të flasë çdo ditë me nipat e mbesat që i ka larg nëpër botë.

Po e mbyll këtu, se nesër do të zgjohem herët. Bashkë me mamin do të dalim për të blerë librat e shkollës. Mami më premtoi se do të më blejë një çantë të re me figurën e Supermenit. Sa qejf!

Natën e mirë!

- **Plotëso me ✓ kur është e vërtetë dhe me ✗ kur është e gabuar.**

Djali është mërzitur	☐ shumë	☐ pak	☐ aspak
Të gjithë i thonë	☐ gjëra të ndryshme		☐ të njëjtën gjë
Gjyshi përdor	☐ telefonin	☐ makinën	☐ kompjuterin
Puna është	☐ detyrë	☐ lojë	☐ argëtim
Figura e çantës ishte me	☐ futbollist	☐ Supermen	☐ arush

SHKRIMI I SHKRONJAVE Uu, Rr, Ee

Uu

Rr

Ee

ura

Era

mami

Miri

ariu

Rimi

muri

Mara

VJERSHAT E STËRGJYSHËRVE

Ju e dini shumë mirë se sa ju duan gjyshërit. Ata kujdesen për ju që të rriteni të shëndetshëm. Ju japin porosi e këshilla se si të silleni, të mësoni, të respektoni familjen, mësuesit dhe njerëzit rreth e qark. Edhe atdheu është një familje e madhe. Stërgjyshërit e atdheut janë njerëz të shquar, që kanë jetuar kohë më përpara dhe kanë shkruar shumë libra me vlerë edhe për kohën e sotme. Në librat e tyre gjuha shqipe ka pak ndryshim nga ajo që përdorim ne sot. Por është shumë bukur që t'i njohim ndryshimet.

Gjuha e mëmës

Gjuhën e mëmëdheut mëso,
ajo mund të të ndritojë,
dhe të tjerat i këndo,
po atë ta kesh për zonjë.

Atë ta dha mëma jote,
bashkë me qumështin e saj,
pa të tjerat prej bote,
i ke mësuar më pastaj.

Naim Frashëri

Porsi kanga e zogut t'verës,
që vallzon n'blerim të prillit,
porsi i ambli flladi i erës,
që lmon gjit e drandofillit:
porsi vala e bregut detit,
porsi gjama e rrfes zhgjetare,
porsi ushtima e nji tërmetit,
njashtu a gjuha e jonë shqyptare.

Gjergj Fishta

Pas dëgjimit të mësueses plotëso:

Vjersha 1
Titulli .....
Autori .....

Vjersha 2
Titulli .....
Autori .....

Detyrë

Zgjidh njërën nga vjershat që të pëlqen më shumë dhe, nëse mundesh, mësoje ta recitosh bukur.

Atdheu

SHEGA: - Atdheu janë malet me borë,
moj Norë.
YLLI: - Atdhe janë fushat me bar,
o Behar.
DODONA: - Janë detet me valë,
moj Suvalë.
NORA: - Atdhe janë drurët me fletë,
moj Mirjetë.
FITORJA: - Atdhe janë zogjtë në degë,
moj Shegë.
BEHARI: - Atdhe janë lepujt në pyll,
O Yll.
MIRJETA: - Atdhe është shtëpia jonë,
moj Dodonë.
SUVALA: - Atdhe është çdo përmendore,
moj Fitore.
TË GJITHË: - Mirëpo, o Erbli,
pa ne dhe pa liri,
ky atdhe
është vetëm dhe.

Arif Demolli

Kupto tekstin

1. Lexo poezinë dhe plotëso.

Atdheu për Shegën janë: .....
Atdheu për Yllin janë: .....
Atdheu për Dodonën janë: .....
Atdheu për Norën janë: .....
Atdheu për Fitoren janë: .....
Atdheu për Beharin është: .....
Atdheu për Suvalën është: .....

2. Si i kupton fjalët e fëmijëve: *pa ne dhe pa liri, ky atdhe është vetëm dhe*? Kërko ndihmë prej më të rriturve.

3. Interpretojeni dhe ju poezinë në role, duke përmendur emrat e njëri-tjetrit.

Familja ime

1. Sa anëtarë ka familja jote?
2. Si shkon me vëllanë ose me motrën tënde?
3. Çfarë di ti për gjyshërit e tu? Si janë njohur ata?
4. Fol për profesionet e gjyshërve të tu.
5. Po për stërgjyshërit a mund të tregosh diçka?

Bisedë me mësuesen

Ka raste kur fëmijët nuk i njohin prindërit e tyre të vërtetë, sepse janë rritur në **Shtëpinë e Fëmijës.** Ata nuk e dinë historinë e stërgjyshërve të tyre. Por, ama, ata e dinë shumë mirë se cilat familje apo njerëz janë kujdesur për ta.

Detyrë

Në një karton të madh ngjit fotografitë e prindërve (ose të kujdestarëve), të vëllezërve, të motrave, si dhe tënden. Nëse nuk i ke të gjitha fotografitë, mund të pikturosh portretet e tyre.

SHKRIMI I SHKRONJAVE Ë ë, R r, L l, Ll ll

Ë

ë

R

r

L

l

Ll

ll

Nina

Lumi

Ela

nina - nana

një

era

nëna

lule

Lisi luan me ariun Leli.

Breshka dhe lepuri

Njëherë, një breshkë po kulloste rrëzë një gardhi. Kur ja, aty pranë kalon një lepur. Ai filloi ta ngacmonte breshkën.

– Sa e ngathët që je, moj e mjera breshkë, – i thotë lepuri duke ngritur veshët.

– Atë rrugë që unë e bëj për pesë minuta, ti s'e bën dot as për një javë.

– Mos fol ashtu, – ia priti breshka. – Unë vërtet jam e ngathët, por ty ta kaloj!

Lepuri qeshi me të madhe. Për t'u tallur me breshkën, ai i tregoi me gisht një kodër atje larg.

– Si thua, a bëjmë një garë?

Breshka pranoi. U nisën të dy menjëherë: breshka dalëngadalë, kurse lepuri si era.

Pas ca kohe, lepuri ktheu kokën prapa. Por breshkën nuk e pa. Ai mendoi se kishte aq kohë, sa dhe mund të flinte. Lepuri u ul nën hijen e një peme dhe ia futi gjumit.

Kurse breshka eci tërë ditën. Kur po arrinte te vendi i mbërritjes, pa lepurin që po vinte me një frymë. Por ishte vonë. Breshka doli e para.

Garën nuk e fiton vetëm këmbëshpejti.

Bedri Dedja (përshtatje)

Kupto tekstin

Mëso fjalë të reja

ia futi gjumit – e zuri gjumi.
po vinte me një frymë – po vinte shumë shpejt.

Përgjigju pyetjeve

1. Kjo është një fabul e njohur në të gjithë botën.
   A të pëlqen fabula? Pse?
2. Pse lepuri u tall me breshkën?
3. A pranoi breshka të bëjë garë me lepurin?
4. Si ndodhi që breshka arriti e para?

- Në fund të fabulës është shkruar një mësim për ne të gjithë:

- Pse lepuri këmbëshpejtë nuk e fitoi garën?
- Pse breshka e ngadaltë e fitoi garën?

Mësoje dhe ti

Në fabula kafshët sillen si njerëzit. Ato kanë cilësi të mira dhe jo të mira.

Plotëso:

Breshkë e duruar	Njeri .....
Lepur mendjemadh	Njeri .....

KUJT I NGJAN TI?

Ne ngjajmë me prindërit, por jo në çdo gjë. Po ti, a u ngjan prindërve të tu? Po gjyshërve?

1. Shkruaj me dy-tri fjali se në çfarë ngjan dhe në çfarë nuk ngjan ti me mamin.

Ndiq shembullin.

Unë i ngjaj mamit nga sytë. Ne i kemi sytë të gjelbër. Edhe unë, edhe mami jemi shumë zemërgjerë. Na pëlqen shumë t'i ndajmë gjërat me të tjerët. Unë nuk ngjaj me mamin nga flokët. Ajo i ka flokët kaçurrelë, ndërsa unë i kam të drejtë.

2. Përshkruaj motrën ose vëllanë (ose ndonjë kushëri).

Cili është vëllai yt (motra jote)?
Si quhet?
Sa vjeç është?
Në cilën shkollë mëson?

Si duket vëllai yt (motra jote)?
Çfarë ngjyre i ka sytë?
Si i ka flokët?
Është i gjatë, mesatar apo i shkurtër?
Është i shëndoshë, mesatar apo i dobët?

Si është vëllai yt (motra jote)?
Si shkon me mësime?
Cila lojë i pëlqen më shumë?
A i pëlqen muzika, vizatimi...etj.?

Si shkoni me njëri-tjetrin?
A i ndani gjërat me njëri-tjetrin?
A grindeni shpesh apo rrallë? Pse?
A i tregoni të fshehta njëri-tjetrit?

SHKRIMI I SHKRONJAVE Kk, Oo, Tt, Pp

K

k

O

o

T

t

P

p

kam

ke ka

kemi

keni

kanë

Ti ke orë.

Keli ka kalë.

Nami ka makinë.

Unë kam tren.

Ata kanë traktor.

Petriti piktworon.

Media e shkruar dhe elektronike

Çfarë janë mediet?

Njerëzit duan të marrin vesh se çfarë ndodh në vendin e tyre a në botë. Për këtë, sa ngrihen në mëngjes, hapin televizorin, telefonin celular, kompjuterin, radion, blejnë gazeta, revista etj. Të gjitha këto mjete me një fjalë të vetme quhen Media.

Rretho cilat nga mjetet e medies janë të shtypura në letër.

Radio

Gazeta



Telefoni celular

Interneti

Televizori

Revista

Sa mërzitemi kur nuk na punon si duhet interneti! Pse?

Rretho.
Në cilat mjete të medies ne shohim figurën, dëgjojmë zërin e folësve, muzikë:

Në kompjuter,
celular,
në revistë,
në televizor?

Cili mjet na mundëson të shohim: filma, të dëgjojmë muzikë, të luajmë?

Shiko figurën dhe thuaj cilat objekte në fotografi janë mjete komunikimi.

Ninullat (këngët e gjumit)

Dëgjo me vëmendje vjershat që lexon mësuesi/ja dhe plotëso ushtrimin.

NINA-NANA, VAJZË E NANËS

Nina-nana, vajzë e nanës,
mori çikë, për bukuri
u bafsh si lule për hijeshi!

Fli, mori çikë, e mbylli sytë,
çeli si yjt e çeli si hanë
ani të rrisin babë e nanë...

(Populllore)

NINA-NANA

Fli, gëzimi im, fli,
në shtëpi është kudo qetësi.
Peshqit po flenë në lumë.
Zogjtë s'ndihen në pyll.
E veshur me dritën e hënës,
çdo degë e gjethe po fle.
Mbylli sytë, biro...
Fli, gëzim, e pusho.

(Me këto vargje muzikanti austriak, Moxarti, kompozoi një këngë.)

- **Shëno me ✓ përgjigjen e saktë dhe ✘ përgjigjen e gabuar:**

Vjersha e parë i këndohet djalit.	☐
Vjersha e dytë i këndohet vajzës.	☐
Nëna e uron vajzën të bëhet si lule.	☐
Në shtëpinë e djalit ka zhurmë.	☐
Zogjtë nuk ndihen në pyll.	☐
Sytë e vajzës janë si lule.	☐
Djali është gëzimi i nënës.	☐

Detyrë. Shkruaj ninullën që të këndonte mami, kur ishe i vogël ose e vogël.

SHKRIMI I SHKRONJAVE S s, H h, Sh sh

S

s

H

h

Sh

sh

pasnesër

shpesh

Shpresa

Sara

Herkuli

Hektori

ha

hamë

hani

sot

nesër

shumë

Sa? Si? Se?

Nga fjalët te fjalia

Lexo me vëmendje fjalitë e mëposhtme:

Unë isha me babin te panairi i librit.

blemë për shumë Ne fëmijë libra.

Edhe babi bleu libra për vete dhe për mamin.

Nënvizo fjalinë që nuk ka kuptim. Shkruaje atë si duhet.

.....

Fjalia përbëhet nga dy a më shumë fjalë. Fjalët lidhen me njëra-tjetrën që të kenë kuptim.

1. Bashko fjalët dhe formo fjali.

Bretkosat po kërpudhën luanin me.

Kërpudha shiu i mbrojti nga bretkosat.

2. Renditi fjalët si duhet te treni i fjalëve:

kaçkavall Miu rrëmbeu trazovaç

djathin nga jonë tryeza



Ushtrohu

1. Dallo me ✓ fjalinë dhe me ✘ ato që nuk janë fjali.

- ☐ Ishte e diel.
- ☐ Diana me prindërit shkuan në panair.
- ☐ Në panair shumë njerëz.
- ☐ humbi mes Diana njerëzve.
- ☐ Polici i fali Dianës një arush.
- ☐ Prindërit e gjetën Dianën.

Ktheji në fjali ato që nuk janë fjali dhe shkruaji në fletore.

2. Formo fjali duke lidhur grupet e fjalëve sipas modelit:

Arushi	prindërve të Dianës.
Këtë histori →	Diana ia tregoi vëllait
Polici	është lodra më e dashur e Dianës.
Diana nuk e dinte	pyeti për emrat e prindërve.
Polici u telefonoi	numrin e telefonit të mamit.

3. Bashko etiketat me njëra-tjetrën që të formosh fjali.

Detyrë. Shkruaj fjalitë në fletore.

SHKRIMI I SHKRONJAVE B b, J j, F f, Nj nj

B	Fëmijë
b	balonë
J	festë
j	ullinj
F	Fatjon
f	Blerta
Nj	Jeta
nj	Jaimir

Është festë. Fëmijët luajnë me balona.

Unë
- flas
- fle
- fshij

Unë
- njoh
- bëj
- festoj

FJALIA ME TË CILËN TREGOJMË

Vajza kërcen me gjyshin.

Djali noton me gjyshen.

Këto fjali na tregojnë se çfarë bën vajza me gjyshin dhe djali me gjyshen.

Fjalitë me të cilat tregojmë, fillojnë me shkronjë të madhe dhe mbarojnë me pikë.

FILLIMI	FUNDI
Shkronja e madhe	Pika

1. Vështro figurat e mëposhtme dhe plotëso fjalitë me fjalët: lojën, fëmijët, gjurin.

..... po vrapojnë.

Vajza vrau .....

Ajo e ndërpreu .....

2. Shiko në figurë Aladinin me llambën magjike. Me tri fjali trego tri dëshirat që do t'i kërkoje të t'i plotësonte llamba magjike.

Unë dua nga ti

.....

.....

.....

.....

SHKRONJA E MADHE DHE PIKA

1. Rretho shkronjën e madhe dhe pikën.

Unë po luaj me kukulla.
Sot ra shi.
Ky laps është i kuq.
Sapo filloi ora e mësimit.

Kukulla quhet Bora.
Gjethet e pemëve shkëlqejnë.
Ylberi ka shtatë ngjyra.
Ne e duam shumë mësuesen.

2. Në tekstin e mëposhtëm vendos shkronjën e madhe dhe pikën aty ku duhet:

Tiku tani e ka ndryshuar sjelljen ai nuk bërtet më për gjërat e tij një ditë mamaja i solli një çokollatë të madhe ai nuk e hëngri çokollatën Tiku e futi atë në çantë në pushimin e madh e ndau me shokët

3. Shkruaji fjalitë si duhet. Vendos ku duhet shkronjën e madhe dhe pikën.

Ishte kohë e keqe lumi. Oshtinte fort papritur. Ai doli nga shtrati lumi. Përmbysi gjithçka njerëzit. Vrapuan të tmerruar.

- **Cilat fjalë janë futur gabimisht në fjalitë e mësipërme?**

E vure re se ç'ndodh kur pika nuk vihet në vendin e duhur?!

Mbaj mend! Çdo fjali fillon me shkronjë të madhe.
Fjalia me të cilën tregojmë, mbaron me pikë.

SHKRIMI I SHKRONJAVE D d, Dh dh, Gj g, Gjj gj

D Gj

d g

Dh Gjj

dh gj

Dielli ndrit shumë.

Tas disa ditësh do të shkoj në Strugë.

Trëndafili ka gjethe të gjelbra.

Ujku, dhelpra, gjarpri, gjirafa janë kafshë të egra.

Edhe mami punon

Unë quhem Ema. Jam shtatë vjeçe. Dje mësuesja na pyeti nëse nënat tona shkojnë në punë. Shumica prej nesh ngritën duart lart. Në familjen time punojnë që të dy, edhe mami, edhe babi. Prandaj edhe unë e ngrita dorën. Mami më ka treguar se, kur linda unë, ajo mori lejen e lindjes dhe nuk shkonte në punë. Kur mbaroi lejen, ajo u kthye në punë. Edhe pse më shumë se gjithçka i pëlqen të jetë mama, ajo e do punën e saj. Njëri nga fëmijët e pyeti mësuesen se pse duhet të punonin të dy prindërit. Mësuesja na tha se prindërit duan të na sigurojnë neve, fëmijëve, një shtëpi të mirë, rroba të bukura, shumë libra, lodra dhe plot gjëra të tjera. Por, të gjitha këto kushtojnë, prandaj duhet të punojnë që të dy. Shoku im, Arti, jeton vetëm me mamin dhe ajo shkon çdo ditë në punë. Ajo do që t'i sigurojë Artit çdo gjë që i duhet, madje edhe paratë për kursin e notit, ku ne shkojmë të dy bashkë.

A mund t'ju them dhe një sekret? Kur isha më e vogël,

qaja kur mami më linte në kopsht dhe ikte në punë. Atëherë mendoja se ajo donte më shumë punën se mua. Tani sigurisht që nuk mendoj më kështu.

Xhenifer Malinos

Kupto tekstin

Mëso fjalë të reja

leja e lindjes - mamatë nuk shkojnë në punë për disa muaj, që të kujdesen për beben e sapolindur.
Me shumë punë e përpjekje prindërit arrijnë **t'u sigurojnë** (t'u krijojnë) fëmijëve një jetesë më të mirë.

Përgjigju pyetjeve

1. Për çfarë folën nxënësit me mësuesen?
2. Çka kishte bërë mami i Emës, kur kishte lindur ajo?
3. Po mami i Artit, pse duhej të punonte më shumë se nënat e tjera?
4. Pse Ema qante kur mami shkonte në punë?

Po ti?

- A mërziteshe kur ke qenë më i/e vogël, se mami shkonte në punë? Pse?
- Për çfarë kujdeset mami, kur është në shtëpi?
- Edhe nënat që nuk shkojnë në punë, punojnë. Ato:

kujdesen për fëmijët; .....
kujdesen për gjyshërit; .....
kujdesen për shtëpinë. .....

Plotëso dhe shkruaj

Prindërit punojnë, sepse .....
.....
.....

Bisedë me mësuesen

Ka raste kur babi ose mami nuk janë në punë. Kjo ndodh, se ata jo gjithnjë e kanë të lehtë të gjejnë punë. Në këto raste ti duhet t'i kuptosh ata, kur nuk kanë mundësi të të blejnë diçka që ti e dëshiron.

PËRSHKRUAJ MAMIN DHE BABIN

1. Kush është mamaja jote?
a. Si e ka emrin?
b. Si e ka mbiemrin?
c. Sa vjeçe është?
ç. Ku punon?

2. Si duket mamaja jote?
a. Çfarë ngjyre i ka sytë?
b. Si i ka flokët?
c. Është e gjatë, mesatare apo e shkurtër?

3. Çka të pëlqen më shumë të bësh me mamin?

.....
.....
.....

1. Kush është babai yt?
a. Si e ka emrin?
b. Si e ka mbiemrin?
c. Sa vjeç është?
ç. Ku punon?

2. Si duket babai yt?
a. Çfarë ngjyre i ka sytë?
b. Si i ka flokët?
c. Është i gjatë, mesatar apo i shkurtër?

3. Çka të pëlqen më shumë të bësh me babin?

.....
.....
.....

SHKRIMI I SHKRONJAVE Yy, Qq, Rr rr

Yy

yy

Qq

qq

Rr

rr

Ylli kapi një yll deti.

Yllka shikon vrugën.

Ylberi ka shtatë ngjyra.

MIQTË E MI TË VEÇANTË



BLEDI

Ana sapo kishte ndërruar shkollë. Nga të gjithë shokët e shoqet e klasës, më interesanti iu duk Bledi.

Ai kishte flokë të verdhë, të prerë si furçë, sy jeshilë, hundë me majë dhe dhëmbë pak të shtrembër. Te dhëmbët e tij të parë kishte një hapësirë, përmes së cilës ai fishkëllente fort fare.

Xhinset i kishte të ngrëna, pasi vishte të vëllait të madh. Pas çdo pushimi, bluzat i bëheshin gjithnjë të papastra. Ndërsa lidhëset e atleteve i rrinin të zgjidhura.

Mëso fjalë të reja

xhinse - farmerka
atlete - patika
gri - i hirtë

Pas dëgjimit, përshkruaj Bledin.

Bledi ka: flokë .....
hundë .....
dhëmbë .....

Bledi ka: xhinse .....
bluzë.....
atlete .....

ERA

Nga të gjitha shoqet e shokët e klasës, Anës më interesante iu duk Era.

Era jeton me mamin, babin dhe ka një mace. Era është gazmore dhe shumë e shkathët. Tregon shumë bukur histori dhe për këtë ka shumë miq.

Era është e veçantë edhe për syzet e saj të kuqe. Pasi u vizitua tek okulisti (mjeku i syve), ai e këshilloi të mbante syze. Dhe Era zgjodhi menjëherë ato të kuqet. Kur shihet në pasqyrë, thotë:

– Ndihem shumë e veçantë me këto korniza të kuqe.

Syzet e kuqe i shkojnë shumë me sytë gri dhe gërshetat e verdhë.

Pas dëgjimit, plotëso portretin e Erës.

Ka flokë .....
Era i ka sytë .....
Mban syze .....

Jeton me .....
Era është vajzë .....
Ajo tregon .....,
prandaj ka .....

PËRSHKRUAJ SHOKUN DHE SHOQEN

Kush është shoku yt (shoqja jote)?
a. Si quhet?
b. Sa vjeç është?
c. Ku banon?

Si duket shoku yt (shoqja jote)?
a. Çfarë ngjyre i ka sytë?
b. Si i ka flokët?
c. Është i gjatë, mesatar apo i shkurtër?
ç. Është i shëndoshë, mesatar apo i dobët?

Si është shoku yt (shoqja jote)?
a. Si shkon me mësime?
b. Cila lojë i pëlqen më shumë?
c. A i pëlqen muzika, vizatimi... etj.?
ç. Është i qeshur, grindavec etj.

Si shkoni me njëri-tjetrin?
a. A i ndani gjërat me njëri-tjetrin?
b. A grindeni rrallë apo shpesh? Pse?
c. A i tregoni të fshehta njëri-tjetrit?

Vizatuesja e vogël

– Nënë, më dhe fletët dhe lapsat, por… nuk di ç'të vizatoj?!
– Po ja… vizato zogun.
– Zogun? Mirë… E vizatova. Po tani?
– Vizato macen.
– Mirë… A të pëlqen?
– Shumë.
– Po tani?
– Vizato qengjin. A di?
– Do ta shohësh. A të pëlqen?
– Po si jo!
– Po tani?
– Vizato… vizato… ujkun.
– Po më del i keq…, i egër…
– Mos u mërzit, i tillë është… Po, mjaft! Bjer e fli!
– Ah, jo! Tani më jep gërshërën.
– Gërshërën?! Pse?
– Ta ndajmë secilin veç e veç. Nata është e gjatë. Nuk ia kam besën as maces për zogun, as ujkut për qengjin…
– Mirë. Ndaji dhe bjer e fli!
– Është herët, nënë. Dua të vizatoj dhe pak.
– Po ç'do të vizatosh ende?
– Një çerdhe… për zogun… një copë livadh për qengjin…



Pas pak vogëlushja u mbështet mbi fletën e vizatimit. Nëna e shtriu ngadalë në shtrat.

Arif Demolli

Kupto tekstin

Mëso fjalë të reja

çerdhe zogjsh - fole

Përgjigju pyetjeve

1. Çka i dha nëna vajzës?
2. Cilin vizatoi në fillim ajo?
3. Po më pas cilat kafshë vizatoi?
4. Pse vajza i kërkoi nënës gërshërën?
5. Cilit nuk i besonte vajza? Pse?
6. A u qetësua më vonë ajo? Pse?

Shëno me ✓ përgjigjen e saktë dhe me ✘ përgjigjen e gabuar.

- ☐ Nëna nuk i dha vajzës fletët dhe lapsat.
- ☐ Vajza i kërkoi ndihmë nënës.
- ☐ Në fillim vajza e pikturoi ujkun.
- ☐ Të dytën vizatoi macen.
- ☐ Vajza kërkoi ngjitës.
- ☐ Vajza nuk i zinte besë ujkut.
- ☐ Vajza nuk i besonte zogut.
- ☐ Vajza fjeti e qetë.

Detyrë

Shiko këto dy vizatime të bëra nga moshatarët e tu. Diskutoni për to në klasë.

Fjalitë janë të ndryshme

Lexo fjalitë e mëposhtme dhe thuaj ç'tregojnë.

Hana po vizaton.	(Fjali me të cilën tregojmë.)
Çfarë po vizaton Hana?	(Fjali me të cilën pyesim.)
Ua, sa pikturë e bukur!	(Fjali me të cilën shprehim habi.)

- Shiko si mbarojnë fjalitë. Mëso këto shenja pikësimi.

. **PIKA**

? **PIKËPYETJA = PIKË + PYETJA**

! **PIKËÇUDITJA = PIKË + ÇUDITJA**

Ushtrohu

1. Lidhi fjalitë me figurat. Vendos shenjat e pikësimit.

a. Djali u zgjua nga gjumi
Ua, paska dalë dielli

b. Sa është ora
Ora është 7

c. Ua, sa jam vonuar
Mami, a do të arrij në kohë në shkollë

2. Vendos shenjat e pikësimit në fjalitë e mëposhtme:

Dielli sapo ka lindur_ Një gjel ka hipur mbi gardh_ Ua, sa i bukur është_ Sa bukur këndon_ Çdo mëngjes ne dëgjojmë këngën e tij_ Kirikikiu_ Ndonjëherë unë mërzitem me të_ E dini pse_ Ai më zgjon herët edhe ditët e pushimeve_

Detyrë. Krijo një fjali me të cilën tregojmë, një fjali me të cilën pyesim dhe një fjali me të cilën shprehim çudi ose habi.

SHKRIMI I SHKRONJAVE ţ c, v v, ţ ç

ţ	celular
c	cirk
v	çati
v	çelës
ţ	vera
ç	pranvera

Visari i dhemb dhëmbi.

Valbona vuri vathët në vesh.

Çfarë po bën maçoku në çati?

Si ishte pica?

Trego një ngjarje

1. Plotëso tekstin e mëposhtëm me fjalët që duhen:

Unë quhem Jona dhe jam pak e turpshme. Një ditë, në shtëpinë tonë kishin ardhur .....
..... .
Atë kohë unë po luaja ..... .
Mami dhe babi më thirrën të shkoja te dhoma e ndenjjes, që të takoja miqtë e tyre. Kur shkova atje, babi më tha:
– Hajde tani, ... , trego çka di të bësh më mirë.
Unë u turpërova dhe..... Miqtë më bënin pyetje të gjithë menjëherë.
– Mos ta ka ngrënë macja gjuhën? – .....
Ika me vrap dhe ..... në ..... time.

mos ki turp *më ngacmoi mami* *disa miq të mamit dhe të babit*

në dhomën time *nuk fola fare* *dhomën* *qava*

2. Shkruaj dy fjali që tregojnë ku bënë gabim prindërit e Jonës.

.....

.....

3. Shkruaj një rast kur je ndier i turpëruar. P.sh.:

- kur ke dashur të njihesh me shokë apo shoqe në park apo në ndonjë vend tjetër;
- kur të ka pyetur mësuesja në klasë;
- kur ke recituar një vjershë para të tjerëve etj.

.....

.....

.....

.....

SHKRIMI I SHKRONJAVE Th th, X x , Xh xh

Th

th

X

x

Xh

xh

thupër

uthull

xixë

xixëllonjë

nxënës

xhep

xhinse

themi

them

thonë

Katën yjet xixëllojnë si xixëllonja.

Xhaketa e babit është e re.

Thuprat e bashkuara nuk thyhen.

PYESIM DHE PËRGJIGJEMI

A. PYESIM
- Si quhesh?
- Nga je?
- Kur ke ardhur në Shkup?
- Në cilën shkollë ke qenë?
- Të pëlqen shkolla jonë?

B. PËRGJIGJEMI
- Quhem Arlind.
- Unë jam nga Tetova.
- Në Shkup kam ardhur para një muaji.
- Kam qenë në shkollën "Rreze drite".
- Po, më pëlqen shumë.

Me fjalitë e shtyllës A bëjmë pyetje, ndërsa me fjalitë e shtyllës B marrim përgjigje. Që të pyesim dhe të përgjigjemi duhet patjetër të jemi dy ose më shumë veta.

- Bëji dhe ti pyetje shokut të bankës, sipas shembujve të mësipërm. Pastaj kërko nga ai të të pyesë dhe ti përgjigju.

USHTROHU

1. Përgjigju pyetjeve të mëposhtme:

Kur shkon në shkollë? .....
Me çka shkon në shkollë? .....
Ku luan në pushim? .....
Kush është shoku yt i ngushtë? .....
Kush është shoqja jote e ngushtë? .....
Cila është loja jote më e pëlqyer? .....

2. Bëj pyetje që të fillojnë me Kush...?, Cilët...?, Çfarë...?, Ku...?, Si...?) që të marrësh këto përgjigje: ..... Kjo është Diana.
..... Diana po këndon.
..... Fëmijët dëgjojnë këngën e Dianës.
..... Diana po këndon shumë bukur.

3. Përgjigju me Po ose me Jo këtyre pyetjeve që janë për ty.

Po ti, tetë vjeç je? *Jo, unë jam shtatë vjeç.* Ose *Po, unë jam tetë vjeç.*
Në klasën e dytë je ti? .....
A luan me top? .....
Cila lojë të pëlqen? .....
A ke bibliotekë në shtëpi? .....

Detyrë. Shkruaj 4 pyetje dhe përgjigjet e tyre.

SHKRIMI I SHKRONJAVE Z z, Zh zh

Z zanë

z zebër

Zh zemër

zh zarf

zhytës zhapik zhurmë

Në pyll ra zjarr.

Zjarrfikësit fikën zjarrin.

Gjyshja ime është shumë zemërbardhë.

Fëmijët zhyten në ujë.

Dy shoqet

Tina dhe Alba janë shoqe të ngushta. Ato kanë të njëjtën moshë dhe jetojnë në të njëjtën lagje. Tina nuk dëgjon dhe nuk flet. Për t'u kuptuar me të, Alba mësoi gjuhën e shenjave.

Shoqet merren vesh me njëra-tjetrën nëpërmjet lëvizjes së gishtave. Kur vendosin dorën mbi gojë, do të thotë se janë të lira.

Kur gishti i madh i pëllëmbës drejtohet poshtë, do të thotë se ato duan të dalin jashtë në oborr që të lozin.

Kur gishti i madh i dorës drejtohet lart, ato i thonë "po" shoqja-shoqes.

Kur gishti i madh i dorës drejtohet nga vetja, do të thotë: "Hajde në shtëpinë time të luajmë së bashku".

Kështu Alba çdo ditë mëson shenja të reja. Dhe çdo ditë miqësia e tyre bëhet më e madhe.

Kristina Nystlinger

Kupto tekstin

Mëso fjalë të reja

gjuha e shenjave -

Këtë gjuhë e përdorin njerëzit që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin.

Çfarë i thonë shoqet njëra-tjerës me këto shenja të duarve?

Përgjigju pyetjeve

1. Çfarë janë Tina dhe Alba?
2. Pse Alba e mësoi gjuhën e shenjave?
3. Si merren vesh shoqet me njëra-tjetrën: me fjalë apo me gishta?
4. Po ti, si do të veproje po të ishe në vend të Albës?

Si kuptohemi me të tjerët?

Për t'u thënë diçka të tjerëve, ne përdorim fjalët. Por ka edhe mënyra të tjera. Djali në figurë dëshiron t'i thotë vajzës se ajo është shoqja e tij më e mirë. Shiko si vepron ai:

Me zë

Me shkrim

Me pikturë

Me lëvizjen e dorës

Me këngë

1. Lidh me shigjeta:

këndojmë	me fjalë
flasim	me ngjyra
pikturojmë	me gishta
bëjmë shenja	me tinguj

2. Shoku yt i ngushtë ka dalë nxënësi më i dalluar i shkollës.
Përdor mënyrat e mësipërme për ta uruar.

Fjalët e përshëndetjes

a. **Mirëmëngjesi!** **Mirëdita!** **Mirëmbrëma!**

b. **Ditën e mirë!** **Drekën e mirë!** **Natën e mirë!**

Fjalët e sipërme i përdorim **kur takohemi.**

Fjalët e poshtme i përdorim **kur ndahemi.**

Siç e vure re, në fund të përshëndetjeve vihet **pikëçuditje** !.

Shkruaj

1. Kur takon një shoqe në mëngjes, si e përshëndet? .....
2. Kur del nga shkolla, si e përshëndet mësuesen/in? .....
3. Kur vjen në shtëpi, si përshëndet? .....
4. Kur shkon për të fjetur, si përshëndet? .....

5. Vendos pikën, pikëpyetjen dhe pikëçuditjen në vendin e duhur:

Atë pasdite ne do të shkonim në kinema me mamin dhe me babin Kur po dilnim, ra zilja e derës Mami hapi derën dhe tha:
– Mirë se erdhët
– Mirë se ju gjetëm
Ishte tezja me fëmijët e saj. Tezja pyeti:
– Po ju po dilni
– S'ka gjë, s'ka gjë, – tha mami. – A doni të rrimë në dhomën e pritjes
– Jo, jo, më mirë këtu në verandë
Ndërsa ne fëmijët dolëm jashtë në oborrin e shtëpisë

Pika, presja dhe pikëpyetja

- Lexo fjalitë e mëposhtme dhe thuaj ku është përdorur **● PIKA , PRESJA ? PIKËPYETJA** .

1. Çfarë libri po lexon Mimi?
   Mimi po lexon një libër me përralla.
2. Çfarë ngjyre është kapaku i librit, që ti po lexon?
   Kapaku i librit është i gjelbër.
3. Çfarë është vizatuar në kapak?
   Një zemër.
4. Si titullohet libri, të cilin e bleve dje?
   Titulli i librit është *"Përralla të zgjedhura"*.

Ushtrohu

1. Vendos pikën, presjen dhe pikëpyetjen aty ku duhet.

a. – Të dielën ne shkuam në parkun e lojërave_ Po ju_ dolët shëtitje_
– Jo_ ne ndenjëm në shtëpi_ Ishte ftohtë në park_
– Jo_ Koha ishte shumë e bukur_ Dielli shkëlqente_
– A kishin çelur lulet_
– Po_ lulet kishin çelur_

b. – Neve na erdhën disa kushërinj për drekë_ Babi poqi mishin_ Mami bëri një tortë shumë të shijshme_ Po babi yt gatuan_
– Babi im nuk gatuan_ Ai bën pazarin_ Po babi yt_ bën pazar_
– Po_ edhe babi im bën pazar_

2. Vendos shkronjën e madhe, pikën, presjen ose pikëpyetjen në fjalitë e mëposhtme:

të dielën mami u mërzit shumë ajo do të shkruante diçka në kompjuter ekrani nuk ndizej ajo mori në telefon një teknik:
- alo më falni kompjuteri im nuk punon
- çka ka
- nuk ndizet ekrani
- ndize dhe fike disa herë pastaj më telefono prapë
- faleminderit!
- për fat të mirë herën e dytë ekrani u ndez

Vjeshta

U zhduk vapa, shkoi vera,
dhe bilbili më s'këndon.
erdhi vjeshta me të tjera,
syri ynë i shikon.

Era fryn, fletët bien,
pemët zhvishen si nga mot,
mali, fusha më s'ka hijen,
që e kishin gjer' më sot.

Bukuritë janë zhdukur,
shiu e bryma zuri vend,
bari, lulet, kopshti i bukur,
u ndryshuan në çdo kënd.

Por e mirë është vjeshta,
sepse bujku gjithmonë punon,
për të vjelë, sot ka vreshtat,
nesër arat do lërojë.

Aleksandër Stavre Drenova *(Asdreni)*



Kupto tekstin

Mëso fjalë të reja

si nga mot – si çdo vit.
bryma – shtresa e hollë e vesës që ngrin mbi lule, bar, tokë kur bëhet ftohtë.
vjel vreshtin – këpus e mbledh rrushin nga vreshta.
lëroj arën – punoj tokën për ta mbjellë.

Mëso:
Vjersha ndërtohet me vargje dhe strofa:



Plotëso:
Vjersha "Vjeshta" ka ..... strofa.
Çdo strofë ka ..... vargje.

Përgjigju pyetjeve

1. Pse poeti thotë që erdhi vjeshta me të tjera? Shëno me ✓ përgjigjen e saktë:

Vjeshta erdhi

- ☐ me shi
- ☐ me qiell të kthjellët
- ☐ me gjelbërim
- ☐ me rrush e mollë
- ☐ me diell
- ☐ me re të dendura
- ☐ me gjethe të vyshkura
- ☐ me qershi e pjeshkë

2. Pse poeti thotë *mali, fusha më s'ka hijen*? **Shëno me ✓ përgjigjen e saktë:**

- ☐ Mali dhe fusha nuk janë më të gjelbëruara.
- ☐ Mali dhe fusha janë njëlloj në çdo stinë.

Plotëso dhe shkruaj

Vjeshta është e mirë, sepse ..... freskohet.
Vjeshta ..... e mirë, sepse bujku ..... vreshtin.
..... është e mirë, sepse ..... lëron ..... .

Detyrë

Mëso ta lexosh bukur vjershën.

PËRSHKRUAJ VJESHTËN

- Trego për çfarë të pëlqen dhe për çfarë nuk të pëlqen stina e vjeshtës.

1. Plotëso tekstin për vjeshtën duke vendosur fjalët e gjetheve në vendet bosh.



zhvishen

zhduken

për t'u vjelë

e dendura

ndryshon pamje

plot me ngjyra

arra

të verdha

Nëna natyrë e ka pikturuar vjeshtën ..... . Degët e pemëve ..... dhe gjethet ndryshojnë ngjyrën. Ato bëhen ....., të kuqe, kafe. Ngjyrat e verës, e gjelbra dhe e kaltra .... Ajri është i freskët dhe ditët shkurtohen e qielli ..... . Retë .... dhe të fryra nga shiu shpërndahen nga era. Në vreshta rrushi është gati ..... . Është bukur të shëtisësh në pyll, të mbledhësh gështenja, ... dhe kërpudha.



E gjelbra, e kaltra dhe vjollca janë ngjyra "të ftohta". Ato na kujtojnë freskinë e pyjeve, ftohtësinë e dimrit dhe pafundësinë e qiellit.

E verdha, e kuqja dhe e portokallta janë ngjyra "të ngrohta". Ato na sjellin në mendje diellin, zjarrin dhe nxehtësinë e verës.

2. Bëj dhe ti një përshkrim të stinës së vjeshtës.



.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Punë në grup

Realizoni së bashku një kolazh me gjërat e vjeshtës.

Fjalia pohore dhe mohore

• **Shiko figurën. Lexo fjalitë që thonë djemtë. Çfarë tregojnë ato?**

Kujto!
Thuaj një fjali, me të cilën pohojmë dhe një fjali, me të cilën mohojmë.

Tani është vjeshtë.

Jo, nuk është vjeshtë.

Sot ka diell.

Sot nuk ka diell.

Unë e kaloj lumin.

Ti nuk e kalon dot lumin.

Unë notoj si peshk.

Ti nuk noton si peshk.

Unë hidhem si lepur.

Ti s'hidhesh si lepur.

Pohojmë ⟶ PO **Mohojmë ⟶ JO**

Fjalia me të cilën pohojmë, quhet fjali POHORE. Fjalia me të cilën mohojmë, quhet fjali MOHORE.

Fjalia mohore dallohet prej fjalisë pohore nga fjalët mohuese NUK ose S'. Këto fjalëza qëndrojnë para foljes.

Ushtrohu

1. Lidh fjalinë pohore me fjalinë e duhur mohore. Nënvizo fjalët mohuese.

Unë e pi qumështin.	Shoku im nuk ka një qen.
Shoku im ka një qen.	Unë nuk e pi qumështin.
Fëmijët këndojnë bukur.	Koha nuk është e bukur.
Koha është e bukur.	Fëmijët nuk këndojnë bukur.

2. Ktheji fjalitë mohore në pohore dhe anasjelltas në tekstin e mëposhtëm.

Unë dhe gjyshi nuk kemi ndërtuar shtëpi në pemë. Mami dhe babi e kanë parë shtëpinë tonë. Kjo nuk është e fshehta jonë. Mami dhe babi nuk më qortojnë për gjyshin. Gjyshi është mirë me shëndet. Por ai nuk kënaqet kur luan me mua. Gjyshi nuk më ka mësuar shumë gjëra.

Fjalët gjithandej, të gjithë, gjithkund etj., përdoren në fjalitë pohore.
Fjalët askush, asnjeri, askund etj., përdoren në fjalitë mohore.

3. Vendos në vendet bosh fjalët: *gjithandej, të gjithë, askush, asnjëherë, asnjëri, kurrkund.*

Dikush solli në klasë një zog. ..... s'e pa zogun. Cicërimat e zogut dëgjoheshin ..... . Zogu nuk shihej .... kthenin kokën gjithandej. Gjithmonë më kishin pëlqyer shakatë. ..... s'isha kënaqur kaq shumë.

4. Nënvizo fjalët: *askund, asnjëherë, gjithandej, kudo*. Thuaj ku janë përdorur, në fjali pohore apo mohore.

Era kishte rrëzuar gjithandej gjethet e thara. Ato i shihje kudo. Të gjithë fëmijët vendosën të dalin dhe të pastrojnë kopshtin. Asnjëri prej fëmijëve nuk ndenji në shtëpi. Ata i mblodhën gjithandej gjethet e rëna. Askund mbi bar nuk të zinte syri gjethe. Fëmijët asnjëherë nuk harrojnë të kujdesen për kopshtin. Të gjithë fqinjët i lavdërojnë ata.

Libri

Kam një shok,
të dy tok
shkojmë orë pa mërzi.
Më tregon,
më mëson,
shumë gjëra që s'i di.

E shtrëngoj,
e pushtoj
plot gëzim e dashuri.
Fort e dua,
Se për mua
është shok për mençuri.

Pa përtim, me durim,
shoku im më ndihmon.
Dhe ky është...
kush e di?
Libri im që më ndriçon.

Bekim Gaçe

KUPTO TEKSTIN

Mëso fjalë të reja

pa përtim, me durim - ka kuptimin që libri i mëson fëmijët pa u lodhur dhe me dëshirë e dashuri.

Pyetje

1. Cili është shoku që ka vajza?
2. Çfarë i tregon libri vajzës?
3. A mërzitet vajza duke lexuar? Ku duket kjo?
4. Lexo vargjet që tregojnë se vajza e do shumë librin.

Detyrë. Shkruaj titujt e katër librave që të kanë pëlqyer më shumë.

Pema e familjes

Shiko ç'pemë fantastike! Kjo është një pemë e veçantë. Pemët e vërteta nuk kanë emra apo piktura që varen në to. Kjo është pema e familjes së Artinit. Aty mund të shohësh të gjithë njerëzit e familjes së tij.

Gjyshi i Artinit nga babi, Besimi, është nga Gostivari. Kur erdhi me punë në Tetovë, takoi gjyshe Meritën. Ata e pëlqyen shumë njëri-tjetrin dhe u martuan. Lindën tre fëmijë: hallën, axhën dhe babin e Artinit. Edhe gjyshërit e Artinit nga mami u takuan kur ishin të rinj. Gjyshe Shpresa ishte bukëpjekëse, kurse gjysh Shpendi ishte zjarrfikës.

Një ditë, në dyqanin e bukës ra zjarr. Gjysh Shpendi me zjarrfikësen e tij e fiku zjarrin. Aty ata u panë me njëri-tjetrin, u dashuruan dhe më pas u martuan. Lindën katër fëmijë: dy dajat, tezen dhe mamin e Artinit.

Gjyshja ka një vit që nuk jeton më. Artini e kujton me mall. Ndihet i mërzitur nga mungesa e gjyshes. Sa shumë e donte!

Në pemën e familjes së Artinit nuk ka vend për të gjithë paraardhësit e tij. Ja pse ai ka vendosur aty vetëm prindërit dhe gjyshërit e tij. Artini është në mes të trungut të pemës.

Nuria Roka

KUPTO TEKSTIN

1. Përgjigju pyetjeve

- Cilët janë paraardhësit e Artinit nga mami dhe nga babi?
- Si u njohën dhe u martuan gjyshërit e Artinit?
- Pse paraardhësit janë njerëz të rëndësishëm për ne?
- Po ti, a di ndonjë histori për gjyshërit e tu?

2. Shëno me ✓ përgjigjen e saktë dhe me ✘ përgjigjen e gabuar.

- ☐ Pemët e vërteta kanë fotografi të varura nëpër degë.
- ☐ Gjyshja e Artinit nga babi quhej Merita.
- ☐ Gjyshi i Artinit nga mami ishte bukëpjekës.
- ☐ Artini ka dy daja, një hallë, dy teze, një axhë.
- ☐ Në pemën e Artinit janë vetëm fotografitë e gjyshërve dhe të familjes së tij.

DALLOJMË EMRIN

Motra ime ka një **qen**. Çdo ditë ajo e stërvit qenin në **oborr**. Një herë ajo e harroi **çantën** në **shtëpi**. **Qeni** ia solli në **shkollë**. **Shokët** dhe **mësuesja** qeshën.

NJERËZ
motra
shokët
mësuesja

VENDE
oborri
shkolla
shtëpia

KAFSHË
qeni

SENDE
çanta

Fjalët me shkronja të zeza janë EMRA. Emrat na tregojnë: njerëz, kafshë, sende e vende.

1. Shkruaj në fletore emrat sipas tabelës.

çanta, doktoresha, lumi, macja, korridori, treni, këngëtari, gjeli, xhupi, policja, liqeni, flutura, libri, miza, lapsi, mësuesi, mali, peshku, rruga.

Emra njerëzish	Emra kafshësh	Emra sendesh	Emra vendesh
motra			

2. Lidh me shigjetë. Krijo katër fjali duke zgjedhur një emër nga secila bashkësi.

Njerëz	pylli
Vende	fletorja
Sende	lepuri
Kafshë	babai
	bluza
	peshkaqeni
	deti
	këngëtari

.....

.....

.....

.....

3. Plotëso vendet e zbrazëta me emrat: *Fëmijët, oborrin, shkollës, fidanin, bel, pemë, karrocën, djemtë, gropë, tokën.*

..... po mbjellin një ..... në ..... e ..... .

Njëri nga.....po gërmon ..... me..... . Një vajzë po shtyn..... . Djali tjetër po merr .....e ri për ta futur në..... .

Alfabeti i shqipes

Stërgjyshi i Erës po lexonte një libër me kapak të vjetër. Era iu afrua dhe i tha:

– Gjysh, librat e mi janë shumë të bukur, plot me ngjyra. Ky libër është i vjetër. Pse të pëlqen?

– Moj bijë, nuk ka rëndësi nëse libri është i ri apo i vjetër. Libri vlerën e ka brenda. Ja, në këto faqet e shkruara.

– Gjysh, cilët janë këta burra në fotografi?

– Janë ata që zgjodhën dhe miratuan alfabetin e gjuhës shqipe. Ja, këtë alfabetin e abetares sate.

– Si quhen ata?

– Në rreshtin e parë janë: Gjergj Fishta, Mithat Frashëri, Luigj Gurakuqi, Dhimitër Qiriazi, Ndre Mjedja etj.

– Po kjo ndërtesë?

– Kjo ndërtesë është në qytetin e Manastirit. Në këtë ndërtesë u mblodhën burrat më të mençur nga e gjithë Shqipëria që miratuan alfabetin. Ata e donin shumë atdheun dhe gjuhën shqipe.

– Gjysh, dëgjo një vjershë të poetit Naim Frashëri për gjuhën shqipe. Na e ka mësuar mësuesja.

Gjuha jonë sa e mirë
Sa e ëmbël, sa e gjerë!
Sa e lehtë sa e lirë!
Sa e bukur, sa e vlerë!

– Ndërsa Gjergj Fishta e krahason gjuhën shqipe me këngën e zogut të verës, – tha stërgjyshi.

– Sa bukur! – tha Era dhe nisi të këndojë nëpër shtëpi...

Shefik Osmani

KUPTO TEKSTIN

Përgjigju pyetjeve

1. Për çka e pyeti Era stërgjyshin?
2. Pse libri i stërgjyshit është i vjetër?
3. Pse libri i Erës është i ri dhe plot ngjyra?
4. Çfarë tregon libri i stërgjyshit?
5. Cilët e krijuan alfabetin e gjuhës shqipe?
6. Si quhet qyteti, ku u miratua alfabeti i shqipes?

Krahaso

• Vendos fjalët e duhura: *me ngjyra, të vjetër, pa ngjyra, të ri.*

Libri i stërgjyshit e ka kapakun ..... dhe ..... .

Libri i Erës e ka kapakun ..... dhe ..... .

Plotëso

• Plotëso fjalitë e mëposhtme duke zgjedhur pjesët e duhura:

...është kujtim nga gjyshi i tij. *...tregon historinë e alfabetit të gjuhës shqipe.*

....tregon historinë e familjes.

Albumi i gjyshes është me vlerë, sepse.....

Vazoja e babait ka vlerë, sepse .....

Libri i gjyshit është me vlerë, sepse.....

Detyrë

Mësoji dhe ti vargjet për gjuhën shqipe.

USHTRIME PËR EMRIN

1. Shkruaj në tabelën e duhur emrat që janë në të djathtë.



mësuesja, gota, lopa, babi, ujku, ndërtesa, këngëtari, sportistja, qyteti, sheshi, ariu, çelësi, banka, kodra, dhelpra, lapsi

2. Plotëso tekstin me emrat e dhënë: *shkolla, klasa, kate, vizatimet, mure, nxënësit, lulet, vazo, mëngjes.*

..... jonë është e re. Ajo është me dy .... jonë është në katin e dytë. Në ..... ka vizatime të bukura. ..... i kanë bërë ..... . Në dritare ka disa ..... me lule. Mësuesja na këshillon t'i ujisim ..... çdo ..... .

3. Shkruaj katër emra njerëzish që kanë profesione të ndryshme.

murator....., ..., ..., ...

4. Shkruaj katër emra sendesh që gjenden në çantën tënde.

....., ..., ..., ...

5. Shkruaj katër emra kafshësh.

....., ..., ..., ...

6. Shkruaj katër emra vendesh.

....., ..., ..., ...

Në fshat

– Miri, Arta, shpejt, bëhuni gati! Erdhi ora të nisemi. Do të shkojmë në fshat të takojmë gjyshen dhe gjyshin. Dhe mos harroni, nuk do të merrni me vete asnjë pajisje elektronike.

– Uf! Auuu, edhe kjo mami! S'na la fare të qetë. E ç'do të bëjmë ne atje pa pleistejshën, – thanë të dy njëzëri, vëlla e motër.

"Ham-ham-ham!" lehte Bajamka, qeni i vogël qimekafe, që ngjante vërtet si bajame me atë turirin e tij të mprehtë. Bajamka ishte më e gëzuara nga të gjithë, pasi e kuptoi se, më në fund, do të dilte shëtitje.

U desh vetëm pak kohë që të gjithë të bëheshin gati. Fëmijët zunë vend në pjesën e pasme të makinës, bashkë me Bajamkën, e cila nxirrte kokën nga dritarja. Ndërsa mami, si gjithnjë, në vend të parë. "Bër-bër, bëëërrrr, brëëm!" dhe babi e nisi makinën.

Sapo makina u fut në oborrin e shtëpisë, gjyshi dhe gjyshja dolën gjithë gëzim nga shtëpia. U takuan me shumë përqafime dhe të puthura.

Vetëm ta shihje Mirin! Edhe pse nuk kishte dashur të vinte në fshat, tani ishte më i gëzuari. Luante me top me të motrën në oborrin e madh dhe nuk ndalonte së vrapuari për asnjë çast.

– Hajde, Miri, kape këtë pasin e gjatë! Hop, hidhu edhe ti, Bajamkë! Shpejt, më shpejt, pas meje! – fliste me zë të lartë Arta dhe faqet i ishin skuqur si prush.

Nga brenda vinte aromë e mirë. Gjyshja sapo kishte pjekur byrekun dhe fëmijët vrapuan të uritur për të ngrënë. Tryeza ishte e shtruar me perime të freskëta, me sallata të saposhkulura nga kopshti para shtëpisë, kajmak e djathë të bërë nga gjyshi e plot gjëra të tjera të mira të gatuara nga gjyshja.

Katerian Mananedaki

Kupto tekstin

Mëso fjalë të reja

Themi **kape këtë pasin,** kur luajmë futboll dhe ia pasojmë shokut topin.

Kajmak ose ajkë, shtresa me yndyrë që zë përsipër qumështi.

Përgjigju pyetjeve

1. Ku shkuan Miri me Artën?
2. Pse u mërzitën motra dhe vëllai?
3. Cila ishte më e gëzuar? Pse?
4. Çka ndodhi sapo makina hyri në oborrin e shtëpisë?
5. Çka hëngrën fëmijët në fshat:

- ☐ petulla
- ☐ sallatë
- ☐ byrek
- ☐ supë
- ☐ kek
- ☐ kajmak

Po ti?

Çfarë merr me vete kur shkon në piknik ose në shëtitje?
Pse kënaqesh kur je në natyrë?

Flasim për fshatin

1. Pyetje për fëmijët që jetojnë në qytet:
a. A ke qenë ndonjëherë në fshat?
b. Të pëlqen fshati? Pse?
c. A i do kafshët apo ke frikë prej tyre?

2. Pyetje për fëmijët që jetojnë në fshat:
a. A të pëlqen të shkosh në qytet? Pse?
b. Të pëlqen të jetosh në pallatet me shumë kate?
c. Ke frikë nga makinat apo të pëlqejnë ato?

Familjet që jetojnë në fshat, kujdesen për kafshët dhe për shpendët. Fshatarët punojnë tokën, e mbjellin atë dhe prej saj marrin grurë, patate etj., që janë ushqime për njeriun. Gjithashtu, nga toka ata marrin dhe ushqimin për kafshët.

3. Shiko figurat e mëposhtme. Fol për to.
Cilat kafshë mbahen në stallë? Cilët shpendë mbahen në kotec? Po qeni ku rri?

a)

b)

c)

ç)

4. Shiko figurat e mëposhtme dhe fol për to.

5. Në cilën fotografi punohet toka dhe në cilën korret gruri?

DALLOJMË EMRAT E NJERËZVE, TË KAFSHËVE...

Të gjithë njerëzit kanë një emër të përveçëm, që i dallon ata nga të tjerët. Kur marrim në shtëpi një kafshë, i vëmë emër, po kështu edhe lodrave. Edhe ushqimeve u vihen emra nga ata që i prodhojnë.

Emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe.

1. Përgjigju me shkrim

Si e ke emrin? .....
Si e ka emrin mami? .....
Si e ka emrin babi? .....
Si e ka emrin vëllai ose motra jote? .....
Si e ka emrin shoqja e ngushtë? .....
Si e ka emrin shoku i ngushtë? .....
Si ia ke vënë emrin lodrës që të pëlqen më shumë? .....
Si e ka emrin një kafshë që ti pëlqen? .....

2. Te ne erdhi për vizitë xhaxhi Joni. Mami Linda e qerasi me lëng portokalli. Lina, motra e madhe, i solli karamele Zana. Motra e vogël, Ermira, i tregoi kukullën Barbi. Andi luan me një mace. Maces ia ka vënë emrin Pupi, kurse arushit ia ka vënë emrin Tedi.

- Ndaji emrat në dy shtylla sipas shembullit:

motra	Lina

3. Shkruaj 4 emra të përveçëm:

njerëzish ....
kafshësh ....
lodrash ....
ushqimesh ....

4. Korrigjo tekstin. Shkruaje në fletore dhe vendos shkronjën e madhe atje ku duhet.

Sot dritani është i lumtur. Qeni i tij bobi fitoi vendin e parë në garën e kafshëve. Vendin e dytë e fitoi qenushja bianka e albanës. reksi, qeni i benit, fitoi vendin e tretë. Motra e vogël e Albanës, eva, shtrëngon nga gëzimi kukullën kesi.

5. Në sendet e mëposhtme shkruaj (a) emrin tënd, (b) emrin e qenit, (c) emrin e kukullës.

a.

b. 

c.

6. Në tekstin e mëposhtëm ngjyros me të kuqe emrat e njerëzve dhe me të kaltër emrat e kafshëve.

Arditi dhe motra e tij, Anila, i duan shumë kafshët. Ata kanë një qen që e thërrasin Lordi dhe një mace që ia kanë vënë emrin Pisika. Kurse shoku i tyre, Ermali, ka një qen që e ka emrin Reks. Motra e Ermalit, Denisa, ka një breshkë që ia ka vënë emrin Beka. Fëmijët kujdesen shumë për kafshët e tyre.

7. Vendos emrat e dhënë në bashkësitë e mëposhtme:

Emrat që tregojnë njerëz	*Emrat e përveçëm të njerëzve*
këngëtare	Mira
.....	.....
.....	.....
.....	.....
.....	.....

këngëtare, Mira, Ariani, mësuese, Vera, punëtor, Ylli, Petriti, mjeku, xhaxhi, teze, Drita.

8. Plotëso vendet bosh me emrat që duhen:

Unë jam vajzë/djalë. Unë quhem .....

Fqinji im ka një djalë. Ai quhet .....

Maces sime kuqalashe ia kam vënë emrin .....

Qeni im është me lara. Unë e quaj .....

Kukulla me flokë të zinj quhet .....

Arushi im quhet .....

9. Korrigjo gabimet te fjalët e mëposhtme:

Inxhinier artani	atlet Artini	Mace kiti	arush Ubi
Mësues Flamuri	nënë drita	qeni bianka	Kukull sheli

Kush banon këtu pranë?

Një pasdite, kur po bënte detyrat e shtëpisë, Vesa e pyeti mamin:

– Mami, cilët janë fqinjët tanë? Çfarë pune bëjnë ata?

– Pse më pyet? – u çudit mami.

– Sepse mësuesi na ka kërkuar një detyrë për profesionet e ndryshme. Dhe unë mendova të shkruaj për profesionet e fqinjëve tanë.

– Shumë mirë paske menduar, – qeshi mami. – Unë nuk i njoh të gjithë fqinjët, siç i njihja te lagjja e vjetër, por me disa mund të të ndihmoj... Babai i Ritës, shoqes sate, është zjarrfikës.

– Po, po, e di, se më ka treguar Rita. Në verë, ata kanë shumë punë, sidomos kur bie zjarr në pyll, – u hodh Vesa.

– Ndërsa mami i Redonit është police rrugore, – tha mami.

– Pa, pa, pa, sa e rreptë që është! – qeshi Vesa. – Por me mua është shumë e dashur.

– Xhaxhi Astriti, te dera përballë, është kuzhinier, – vazhdoi mami. – Të kujtohet kur hëngre makaronat me salcë dhe lëpive gishtat? Ai i kishte bërë enkas për ty.

– Mëëëë, sa të mira që ishin! Edhe tani më lëshon goja lëng... – lëpiu buzët Vesa. Pastaj pyeti:

– Po teta Mira që na sjell gjithnjë byrek aq të mirë, kuzhiniere është?

– Jo, – tha mami, – teta Mira është amvisë. Ajo kujdeset për shtëpinë e saj dhe di të gatuajë shumë mirë. Por nuk është me profesion kuzhiniere, pra nuk punon në kuzhinën e ndonjë restoranti, si xhaxhi Astriti.

– Babi i Yllit është futbollist. A hyn futbollisti te profesionet? – pyeti Vesa.

– Po, sepse ai punon për ekipin kombëtar.

– Sa qejf ta kesh babin futbollist! – tha Vesa. – Ndërsa Ylli më thotë mua: "Lum si ti që e ke babin doktor, se nuk të bën gjilpëra!"

– Ha, ha, ha, – qeshi mami i Vesës. Ajo është pianiste dhe Vesa ka shumë qejf kur mami e merr me vete në prova dhe në koncerte.

Kupto tekstin

Mëso fjalë të reja

Me **profesion** kuptojmë punën (mjeshtërinë, zanatin) e një personi, i cili paguhet ose fiton nga kjo punë.
amvisë - grua që kujdeset për shtëpinë e vet, zonja e shtëpisë.
ekip - skuadër (futbolli, basketbolli, volejbolli etj.).

Përgjigju pyetjeve

1. Në çfarë kohe u bë biseda ndërmjet mamit dhe Vesës?
2. Për çfarë e pyeti Vesa mamin? Pse?
3. Cilin gatim të fqinjit kuzhinier kishte provuar Vesa?
4. Cili nga prindërit e merr Vesën me vete në punë? Pse?

Shëno ✓ për përgjigjen e saktë dhe ✘ për të gabuarën.

- ☐ Mami i Vesës është police.
- ☐ Babi i Vesës është mjek.
- ☐ Babi i Yllit është zjarrfikës.
- ☐ Mami i Redonit është pianiste.
- ☐ Fqinji përballë është kuzhinier.

Detyrë. Shkruaj për profesionet e prindërve të tu.

PROFESIONE TË DOBISHME E TË BUKURA

Shkruaj fjalët e etiketave në vendin e duhur.



Veterinerja

Veterinerja ..... . Ajo u pret qimet dhe i mjekon kafshët kur sëmuren. Veterinerja është shumë e ëmbël. Di si t'u flasë kafshëve, që ato të sillen mirë. Dhe, para se të largohen nga klinika, ajo u jep atyre ndonjë gjë të mirë për të ngrënë.

Shoferi

Çdo mëngjes, në të njëjtën orë, autobusët lëvizin në rrugë. Shoferi i autobusit të shkollës sonë ..... .

Muratori

Muratorët ..... shpejt ..... për të banuar. Të gjithë mbajnë kaskë mbrojtëse në kokë dhe qëndrojnë me kujdes në skelë. Janë shumë gazmorë. Pothuajse gjithmonë të përshëndesin kur kalon poshtë skelave.

Shitësja

Sa qejf është kur del për të blerë! Shitësja na ndihmon gjithmonë të zgjedhim atë që na duhet. Ajo ..... . Ajo e di edhe se çfarë dhurate duhet të blejmë për festën e mamit.

Piloti i avionit

Kur avioni ngrihet nga toka, të gjithë mbajmë frymën. Pilotët .... Të gjithë ndihemi të sigurt në udhëtim. Për pak kohë ne bëhemi si zogj. Kur prekim sërish tokën, ne falënderojmë pilotët me duartrokitje.

Piktorja

Fqinja ime është piktore. .... Mua më pëlqejnë shumë. Kur i shikoj, unë frymëzohem prej tyre. Unë kam filluar të pikturoj. Disa nga shoqet e shokët e mi pëlqejnë muzikën ose poezinë. Arti ta bën jetën më të bukur.

Dallojmë emrat e vendeve

Kujto! Emrat që u vëmë njerëzve, kafshëve dhe sendeve shkruhen me shkronjë të madhe.

Për të dalluar edhe vendet, njerëzit u vënë emra *qyteteve, fshatrave, lumenjve* etj.

- Lexo tekstin e mëposhtëm:

Një ditë mësuesja na tha se do të bënim një ekskursion në **Shkup**. Rrugës për atje ndaluam në qytetin e **Tetovës. Në Shkup** u ngjitëm në kala Nga kalaja pamë lumin **Vardar**.

Çfarë tregojnë fjalët me shkronja **të zeza**?
Emrat e këtyre vendeve shkruhen me shkronjë të madhe.

Nënvizo emrat e përveçëm. Shiko ndryshimin.

qyteti i Tetovës fusha e Pollogut mali i Sharrit lumi Drin

Ushtrohu

Vendos shkronjën e madhe aty ku duhet.

a. Në fund të javës ne shkuam në qytetin e strugës. Rrugës pamë lumin shkumbin, kalanë e tetovës, fushën e pollogut, malin e sharrit e vende të tjera. Po ti, a ke qenë ndonjëherë atje?

b. Kur shkova në gostivar për pushime, takova shokun tim, ilirin. Ai kishte një qen të madh që quhej balo. Unë kisha me vete qenushin tim popi. Në fillim kisha frikë se mos baloja i sulej popit. Por ata u miqësuan shpejt me njëri-tjetrin. Kënaqeshin kur i shëtisnim në parkun e gërmisë.

LEXOJMË

Letra e Babadimrit

Sofia po e priste me padurim natën e Vitit të Ri. Ajo gëzohej për çdo ditë dhjetori që kalonte. Shihte në kalendar se po afrohej nata e shumëpritur. Por gëzimi i saj nuk ishte i plotë, sepse shokët dhe shoqet e klasës e tallnin. I thoshin që Babadimri nuk ekzistonte. Thjesht ishte një shpikje nga të rriturit, që vetëm fëmijët e vegjël mund ta besonin.

Kur kthehej nga shkolla, Sofia fliste me Tilin, lepurushin e saj prej pelushi. Ata kuptoheshin shumë mirë me njëri-tjetrin. Sofia njihej me të që prej kohës kur ishte bebe.

– O Tili, më mirë mos të kisha thënë se Babagjyshi ekzistonte, – fliste përgjumësh Sofia.

Ndërkohë, në mes të natës, kur e gjithë shtëpia flinte, vetëm Tili ishte i zgjuar. Ai po i shkruante një letër urgjente Babadimrit. Tili i lutej atij që t'i jepte një shenjë Sofisë se ai ekzistonte. Në atë çast ra zilja dhe, fap, u shfaq postieri. Ai mbante në dorë një letër që i drejtohej Sofisë dhe lepurushit Tili. Postieri iu lut të dyve që të nënshkruanin në bllokun e tij, për të treguar se e kishin marrë letrën.

Sa me qejf e vuri nënshkrimin Sofia! Ndërsa lepurushi uli kokën, se nuk dinte të nënshkruante. Sofia i tregoi se si mund ta bënte nënshkrimin duke futur putrën në bojë. Sa bukur doli nënshkrimi i Tilit! Pastaj të dy u ulën pranë oxhakut dhe Sofia filloi të lexonte letrën.

23. 12. 2021

Të dashur vogëlushë,
Unë do të ekzistoj gjithmonë, derisa fëmijët e botës do të besojnë tek unë.
Ndoshta është e vështirë ta kuptoni, por, nëse vërtet besoni në diçka, ajo mund të bëhet e vërtetë.
Çdo vit, natën e Vitit të Ri, unë udhëtoj dhe shkoj te të gjithë ata fëmijë që besojnë tek unë.
Së shpejti do të vij edhe te ju, bashkë me dhuratat.

Me dashuri,
Babadimri

– Ah, paskam parë ëndërr, – tha Sofia, duke fërkuar sytë. Po në çast u ngrit hop nga shtrati dhe, me lepurushin në dorë, vrapoi në dhomën e ndenjjes, ku ishte bredhi.

Atje gjeti vërtet dhuratën e Babadimrit. Dhe e puthi Tilin fort, fort nga gëzimi.

Marçelo Arxhili

Kupto tekstin

Mëso fjalë të reja

shpikje nga të rriturit, pra që e kanë sajuar, kanë thënë një gjë që nuk është e vërtetë.
urgjent - menjëherë.
nënshkruaj - do të thotë vë një shenjë, emrin ose mbiemrin në formë të shkurtuar.
putër - shputa e këmbës e disa kafshëve dhe e njeriut

Përgjigju pyetjeve

1. Çka e gëzonte dhe çka e mërziste Sofinë?
2. Cila ishte ëndrra që pa Sofia?
3. A u bë e vërtetë ëndrra e Sofisë? Pse?
4. Pse postieri kërkoi që Sofia dhe Tili të nënshkuanin?
5. Si nënshkroi Sofia dhe si e vuri nënshkrimin lepurushi?

Sofia

Po ti?

1. Po ti, a e pret me padurim natën e Vitit të Ri? Pse?
2. Çfarë bën në ditët para festës?
3. Të pëlqen të besosh se Babadimri ekziston?

Gjej fjalët e duhura dhe plotëso

Unë do të ..... gjithmonë, derisa fëmijët e botës ..... tek unë.
Nëse vërtet besoni në diçka, ajo mund .....
Çdo vit, në natën e Vitit të Ri, unë ..... .
Unë shkoj te ..... që besojnë tek unë.
Së shpejti do të vij te ju, ...

KARTOLINA

Shiko modelin se si shkruhet urimi në një kartolinë.

E dashur teze Mira,

Gëzuar Vitin e Ri 2021!

Me shumë dashuri
nipi yt, Lisi

1. Shkruaj tri kartolina:

a. për shokun
b. për mësuesin ose mësuesen
c. për kushërirën ose kushëririn që jeton jashtë shtetit.

• Bëj dhe ti pemën e Vitit të Ri. Ndiq radhën e veprimeve:



UNË I DUA KAFSHËT

1. Në rast se do të merrje një kafshë ose një shpend në shtëpi, cilin do të zgjidhje ndërmjet:

maces dhe qenit

lepurit dhe peshkut

kanarinës dhe papagallit

Thuaj pse e bëre këtë zgjedhje.

2. Lidh me shigjetë fjalët e dy shtyllave:

Sot i bëra qenit	fara
Shoku im ua ndërroi ujin	të flasë
Entela e mëson papagallin	peshqve
Gjyshi e ushqen lepurin	vaksinën
Nëna i hedh kanarinës	me karota

- Trego pse i lidhe fjalët kështu.

3. Ka disa njerëz që i veshin qenit ose maces rroba. A është gjë e mirë kjo?

4. Shiko figurat e mëposhtme dhe përgjigju këtyre pyetjeve:

a. Kafshët na kënaqin shumë. Thuaj pse.

b. Kafshët ndonjëherë na zemërojnë. Thuaj pse.

c. Kafshët ndonjëherë na lodhin. Thuaj pse.

DALLOJMË MBIEMRIN

Babi i dhuroi Rinës për ditëlindje një papagall. Ai ishte plot me ngjyra.



Fjalët me ngjyra janë mbiemra. Ata tregojnë si është papagalli.

Mbiemrat tregojnë se si janë njerëzit, kafshët, sendet, vendet etj.

Një vajzë e vogël po shëtit në parkun e gjelbëruar qenin e bardhë, që ka në qafë një kordele të kuqe.

Shkruaj mbiemra pranë emrave.

vajza	.....
kordelja	.....
qeni	.....
parku	.....

USHTROHU

1. Nënvizo mbiemrat. Pastaj vendosi në bashkësitë përkatëse këto etiketa.

klasë e pastër | portier i zoti | lumë i thellë
gjethe e gjelbër | lule e kuqe | qen i madh
lepurush i bardhë | mësuese e dashur | kopsht i lulëzuar

Njerëz	Kafshë	Sende-Vende
.....	.....	*lumë <u>i thellë</u>*

2. Lexo mbiemrin dhe shkruaj një emrër para tij.

_____ e verdhë	_____ i thartë
_____ e shkurtër	_____ e shijshme
_____ i ëmbël	_____ i ftohtë

3. Lidh me shigjetë.

portier i mirë	vëllezër të mëdhenj
peshk i kuq	këngë të bukura
këngë e bukur	portierë të mirë
vëlla i madh	peshq të kuq

4. Lexo mbiemrat dhe shkruaj emrin e sendit që ka këto cilësi.

- *e rrumbullakët, e kuqe, e shijshme,* .....
- *i gjatë, i gjelbër, i shijshëm,* .....
- *rrumbullak, i verdhë, i nxehtë* .....

5. Ngjyros mbiemrat.

Në kopshtin e gjelbëruar kishte lule të kuqe dhe lule të bardha.
Eda punëtore i ujit lulet çdo ditë.
Bletët punëtore thithin nektarin e ëmbël.
Arti çamarrok shkul barërat e këqija.

6. Lidh mbiemrat me emrat e dhënë, sipas dëshirës.

të zeza		kafe
të kuqe	pantallona	të bardha
të gjata	këpucë	e verdhë
e vogël	bluzë	të vogla
e madhe	sandale	të shkurtra
e gjelbër		të mëdha

7. Ngjyros mbiemrat në tekstin e mëposhtëm. Çfarë tregojnë ata?

Lulja e kuqe sapo kishte çelur në kopshtin e gjelbër. Dielli i ngrohtë po ia përkëdhelte fletëzat e buta. Djali i vogël e ujiti dhe shkuli ferrën e keqe, që kishte mbirë aty pranë. Një flutur e bukur qëndroi mbi lulen e kuqe.

8. Krijo tri fjali me mbiemrat: *i pastër, e bukur, i kuq.*

KËSHILLA PËR KAFSHËT

1. Vendos në vendin e duhur këto fjalë:

kështilla

peshq

Është bukur të mbash në akuarium .....

Por gjithmonë kujto disa .....

Kujdesu për .....

Peshqit duhet t'i ushqeni .....

Ushqimi më i mirë për ta mund të jetë me .....

Pyesni ..... për ushqimin që u pëlqen .....

Nëse i ushqen peshqit më shumë se sa duhet, ata .....

peshqve

shitësin

ushqimin e tyre

ngordhin

dy herë në ditë

kokrriza ose petëza

2. Për macen dhe qenin është shumë e dëmshme stina e verës. Shkruani dy ose tri këshilla për ta me ndihmën e mësueses/it ose të prindërve.

.....

.....

.....

Mëso fjalë të reja

marule - lloj sallate me gjethe të gjera e të buta.

Dallojmë përemrin. Përemrat vetorë

Unë

Ti



Ai Ajo

Ne

Ju

Ata Ato

Fjalët **unë**, **ti**, **ai**, **ajo**, **ne**, **ju**, **ata**, **ato** janë **përemra vetorë**.
Ata tregojnë veta në numrin njëjës dhe në shumës.

Në numrin njëjës			Në numrin shumës		
Unë	**Ti**	**Ai/Ajo**	**Ne**	**Ju**	**Ata/Ato**
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III

Ushtrohu

1. Plotëso fjalitë me përemra vetorë.

..... jam djalë. ..... je piktore. ..... është sportist.
..... jeni vajza. ..... është këngëtare. ..... janë sportiste.
..... janë djem. ..... jemi më të mirët. ..... janë të shkathët.

2. Vendos përemra vetorë në vend të pikave, sipas modelit.

Çka bëri në pyll Borëbardha? Ajo takoi shtatë xhuxhët.
Si u sollën xhuxhët me Borëbardhën? ..... e pranuan në shtëpi.
Çka bëri njerka? ..... e ndoqi nga prapa Borëbardhën.
A e takoi princi Borëbardhën? ..... e gjeti në gjumë.
A u gëzuan xhuxhët dhe princi kur ajo u zgjua? Po, ... u gëzuan shumë.

Gjashtë vëllezërit peshkatarë

(pjesë teatrore)

SKENA 1

AUTORI: Na ishin njëherë gjashtë vëllezër që vendosën të shkonin për peshkim. Ata shkuan në lumë dhe zunë vende të mira për të peshkuar.

VËLLAI I PARË: Unë do të ulem në këtë varkë.

VËLLAI I DYTË: Unë do të rri mbi këto dërrasa.

VËLLAI I TRETË: Unë do të ulem poshtë pemës.

VËLLAI I KATËRT: Unë do të qëndroj mbi këtë urë.

VËLLAI I PESTË: Unë do të rri mbi këta gurë.

VËLLAI I GJASHTË: Unë do të ulem mbi bar.

AUTORI: Dhe kështu bënë. Secili vëlla peshkonte në vendin që kishte zgjedhur vetë. Dhe secili prej tyre pati fat. Zunë shumë peshq. Por, kur erdhi koha për t'u kthyer, ata u shqetësuan.

VËLLAI I PARË: Ne kemi qëndruar afër lumit, rreth lumit, sipër lumit. Ndoshta njëri prej nesh ka rënë në ujë dhe është mbytur. Unë duhet t'i numëroj vëllezërit, për të parë nëse jemi të gjashtë shëndoshë e mirë.

AUTORI: Dhe ai filloi të numëronte.

VËLLAI I PARË: (duke numëruar)

Shoh një vëlla mbi dërrasa. Një.
Dhe një poshtë pemës. Dy.
Dhe një mbi urë. Tre.
Dhe një të shtrirë mbi gur. Katër.
Dhe një mbi bar. Pesë.
Vetëm pesë!
Oh, Zot i madh!
Kam humbur një vëlla.

VËLLAI I DYTË: Të ketë ndodhur vërtet? Mos është mbytur ndonjëri prej nesh? E tmerrshme?!

AUTORI: Edhe ai, gjithashtu, filloi të numëronte. Por edhe atij i dolën pesë. Po kështu edhe vëllezërit e tjerë. Ata vraponin rreth e rrotull duke bërtitur:

TË GJITHË: O kuku! Çka të thotë nëna jonë e dashur?

SKENA 2

AUTORI: Secili nga vëllezërit numëronte vetëm pesë vëllezër. Kur, papritmas, afrohet një vajzë. Vajza po peshkonte aty afër, por ajo nuk kishte kapur asnjë peshk.

VAJZA: Ç'ka ndodhur? Ju keni kapur gjithë këta peshq. Pse jeni të mërzitur?

VËLLAI I KATËRT: Sepse ne erdhëm të gjashtë për të peshkuar dhe tani ne jemi pesë. Njëri nga vëllezërit na është mbytur në lumë.

VAJZA: Nga e nxorët këtë?

VËLLAI I PESTË: Shiko, ta tregoj unë!

(Dhe tregoi me gisht vëllezërit).

Një…dy…tre…katër…pesë…

AUTORI: Vajza ktheu kokën prapa për të fshehur buzëqeshjen dhe pastaj u tha vëllezërve.

VAJZA: Unë besoj se mund t'ju ndihmoj ta gjeni vëllanë e humbur. Kur unë do të shtrëngoj dorën e secilit, ju do të numëroni.

AUTORI: Ajo ia shtrëngoi dorën secilit vëlla.

(Secili shikonte vajzën tek i shtrëngonte dorën).

VËLLAI I PARË: Një.
VËLLAI I DYTË: Dy.
VËLLAI I TRETË: Tre.
VËLLAI I KATËRT: Katër.
VËLLAI I PESTË: Pesë.
VËLLAI I GJASHTË: Gjashtë.

AUTORI: Gjashtë! Vëllezërit panë njëri-tjetrin të habitur. Ata filluan t'i gjuanin njëri-tjetrit prapa shpinës. Më pas, u kthyen nga vajza.

VËLLAI I GJASHTË: Urdhëro, ja tek i ke të gjithë peshqit tanë. Ne asnjëherë nuk mund të ta shpërblejmë këtë të mirë që na bëre. Ti na gjete vëllanë e humbur.

AUTORI: Kështu vajza mori peshqit dhe u largua. Gjashtë vëllezërit peshkatarë dhe budallenj u kthyen në shtëpi të lumtur, por pa asnjë peshk.

Beniamin Elkin

Kupto tekstin

Pyetje dhe përgjigje

1. Ku shkuan vëllezërit?
2. Përgjigju pyetjeve shpejt:
   a. Ku u ul vëllai i parë?
   b. Ku u ul vëllai i dytë?
   c. Ku u ul vëllai i tretë?
   ç. Ku u ul vëllai i katërt?
   d. Ku u ul vëllai i pestë?
   dh. Ku u ul vëllai i gjashtë?
3. Cili është numri i tyre në fillim të peshkimit?
4. Cili është numri i tyre pas peshkimit?
5. Cili ishte gabimi që bënë vëllezërit në numërim?
6. A e kuptoi vajza që në fillim gabimin e vëllezërve?
7. Si mbaroi dita e peshkimit?
   fitoi (Cila.....?)
   humbën (Cilët.....?)
8. Pse të bën për të qeshur kjo pjesë?

Detyrë

Ndajeni pjesën në role.

- Gjashtë nxënës do të luajnë rolet e gjashtë vëllezërve.
- Një nxënëse do të luajë rolin e vajzës.
- Mësuesi/ja do të lexojë fjalët e autorit.

AI, AJO

Lexo tekstin dhe shiko fjalët me ngjyra.

Fëmijët shkojnë në shkollë.
Ata e kanë larg **shkollën**. **Ajo** është mbi një kodër.

Fëmijët – ATA Shkolla – AJO

Përemrat e vetës së tretë (AI, AJO, ATA, ATO) zëvendësojnë emrat.
Plotëso sipas modelit.

Princi	– ai	Princesha	– .....
Princat	–	Princeshat	– .....
Bambi	–	Falina	– .....
Drerët	–	Drenushat	– .....

USHTROHU

1. Ngjyros përemrat vetorë në fjalitë e mëposhtme.

Unë doja të mbillja një pemë. Ti pse s'erdhe të më ndihmoje? Unë i kërkova ndihmë shokut. Ai hapi një gropë me bel. Unë e mbolla pemën. A keni qejf ju të mbillni pemë? Ato do të rriten shpejt në kopsht. Ai do të zbukurohet.

2. Vendos përemrat ajo, unë, ti, ata, ai aty ku duhet.

– A i pëlqen përrallat .....?
– Po, ... i pëlqej shumë.
Dje gjyshi më tregoi një përrallë. ..... bënte fjalë për një djalë trim. ..... vrau kuçedrën. Djali ua dha lajmin njerëzve. ..... e falënderuan djalin.

3. Zëvendëso emrat me ngjyrë me përemrat *ai, ato, ajo, ata*.

Qyteti im ka ndërtesa të shumta. ..... janë shumë të larta. Në mes të qytetit kalon një lumë. ..... i jep shumë bukuri qytetit. Mbi lumë është një urë. ..... është ndërtuar e re. Qyteti ka shumë fëmijë e të rinj. ..... e gjallërojnë shumë qytetin.

4. Shkruaj katër fjali që të kenë përemra vetorë të vetës së parë dhe të dytë.

NUMËRORI

Dinozaurët kanë gjurmë të ndryshme. Shiko figurat. Janë 11 gjurmë dinozaurësh.

Tani le ta shkruajmë numrin 11 me fjalë: NJËMBËDHJETË

Në librin e matematikës ti ke mësuar numrat: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 etj.
Numrat nuk shkruhen vetëm me shifra, por edhe me fjalë:
Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë etj.

Fjalët që tregojnë numra, quhen NUMËRORË.

Numrat nga 1-19 shkruhen bashkë: një, dhjetë, nëntëmbëdhjetë.
Numrat 20, 30... 50... 100 shkruhen bashkë: njëzet, tridhjetë, pesëdhjetë, njëqind.
Numrat nga 21-99 shkruhen ndaras: njëzet e një, dyzet e pesë, nëntëdhjetë e nëntë.

USHTROHU

1. Shkruaj me fjalë:

Sa motra dhe sa vëllezër ke?

....

Sa kushërinj dhe kushërira ke?

....

Sa vajza dhe sa djem janë në klasën tënde?

....

2. Lidh me shigjetë numrin me numërorin.

1	njëzet e një
7	shtatëmbëdhjetë
11	njëzet
5	**një**
10	shtatë
17	pesë
20	njëmbëdhjetë
21	dhjetë

3. Shkruaj numrat për këta numërorë.

tridhjetë e tre _____ gjashtëdhjetë e shtatë _____

dyzet e pesë _____ shtatëdhjetë e një _____

pesëdhjetë _____ tetëdhjetë e gjashtë _____

nëntëdhjetë e tetë _____ njëqind _____

4. Shkruaj numërorët e numrave të dhënë.

15 _____ 3 _____

81 _____ 6 _____

19 _____ 16 _____

22 _____ 4 _____

5. Shkruaj numërorët.

10 _____ 60 _____

20 _____ 70 _____

30 _____ 80 _____

40 _____ 90 _____

50 _____ 100 _____

6. Shiko figurën dhe shkruaj një tekst të shkurtër ku të përdorësh numërorë.

.....

.....

.....

.....



MEDIA

Në Teatrin e Kukullave

Ti, me siguri, ke qenë në Teatrin e Kukullave. Por, edhe nëse s'ke qenë, i ke parë shfaqjet e kukullave në televizor.

Më parë, aktorët i lëviznin kukullat dhe flisnin që nga poshtë skenës. Dukej sikur kukullat ishin të gjalla. Fëmijët kënaqeshin shumë. Tani aktorët dalin në skenë bashkë me kukullat e tyre. Ka raste kur ata vishen me rrobat e personazheve dhe luajnë vetë në skenë.

1. Lidh me shigjetë se si e bën aktori zërin.

zëri i ujkut	i hollë
zëri i dhelprës	i trembur
zëri i kecave	këshillues
zëri i mamadhisë	me lajka
zëri i kacamisrit	i trashë

- **Pse të pëlqen kjo gjë?**

2. Shiko fotografitë e mëposhtme. Çfarë sheh në to?

3. Kujto një ditë kur ke qenë në Teatrin e Kukullave. Cilën pjesë ke parë? Cilat ishin personazhet e saj?

PËRGATITEMI PËR SHFAQJE

Punë në grup

NJOFTIMI
Për të dhënë një shfaqje, duhet të përgatitemi.
Merrni një tabak të madh dhe shkruani:

Titullin e pjesës që do të shfaqet: .....
Drejtuesin e shfaqjes: .....
Emrin e mësuesit ose të mësueses dhe të njërit prej jush që do të jetë ndihmësi i tij/i saj: .....
Aktorët: .....
Emrat e shokëve të klasës që do të luajnë këto role:
Autori: .....
Vajza: .....
Vëllai i parë .....
Vëllai i dytë .....
Vëllai i tretë .....
Vëllai i katërt .....
Vëllai i pestë .....
Vëllai i gjashtë .....

Përgatitja
Përgatitni disa grepa dhe peshq. Pikturojini me ngjyra në karton dhe pritini.

Plotësoni ftesën



Numërori rendor

Ne sot bëmë një garë vrapimi. Morën pjesë 5 veta. Shoqja ime, Mira, doli e para. Unë i dyti, ndërsa shoku im, Agu, doli i treti.

Mira – e para (shoqja)
Agu – i treti (shoku)

Numërorët e para, e dyta... janë numërorë rreshtorë.

I sati doli Eri? _____.
E sata doli Drita? _____.

Ushtrohu

1. Shkruaj numërorët me fjalë 17, 6, 15, 4.

Unë kisha _____ karamele. _____ prej tyre i hëngra.
Vëllai im kishte _____ karamele. Ai hëngri _____ prej tyre. A kemi tani të dy të njëjtin numër karamelesh?

2. Shkruaj te pikat një numëror rreshtor.

Në rrugë po kalonte një makinë, një fëmijë, një biçikletë.
E para kaloi makina.
_____ ishte një fëmijë.
_____ ishte biçikleta.

Ditë dimri

Era prapë shkundi fletë,
larg i hedh në lumë,
dielli humbi nëpër retë,
retë e vunë në gjumë.

Era lot e bredh e lirë,
erës kush i flet?
Qan një zog në mugëtirë,
urë e drunjtë kërcet.

Era lot e çel një derë,
thyhet larg një lis.
Ngjyrë gri qielli merr,
bora vallen nis.

Oh ç'i zbardh fytyra tokës!
Era fryn e fryn...
Floku i borës nga derë e hapur,
brenda në dhomë hyn.

Xhevat Beqaraj

Kupto tekstin

Plotëso dhe shkruaj

Vjersha ka ..... strofa.
Në strofën ..... floku i borës hyn në dhomë.
Në strofën ..... dielli fle.
Në strofën ..... thyhet një lis.
Në strofën ..... qan një zog.

Mëso fjalë të reja

mugëtirë – para se të bjerë nata, kur drita është e dobët dhe ende nuk ka ardhur errësira e natës.
lot – loz, luan
gri – e hirtë, e përhirtë

Cila është ngjyra e tokës në këtë ditë dimri? .....
Cila është ngjyra e qiellit në këtë ditë dimri? .....

Rretho ose ngjyros fjalën që përsëritet më shumë në këtë vjershë:

bora fletët qielli era lisi

Detyrë

Mësoje ta recitosh bukur vjershën. Shqipto bukur rimat që i japin melodi vjershës: *fletë-retë, lumë-gjumë* etj.

DALLOJMË FOLJEN

Bie borë.

Djali **rrëshqet** me ski.

Vajza **bën** plak bore.

Fjalët **bie**, **rrëshqet**, **bën** janë folje.

Folja tregon se çfarë bëjnë njerëzit, kafshët dhe sendet. Folja tregon një **veprim**.

Vendos foljet luajnë, vrapojnë, këndojnë **në fjalinë e duhur**.

Atletët ..... .

Fëmijët ..... .

Djali dhe vajza .....

USHTROHU

1. Gjej fjalën që tregon veprim dhe ngjyrose.

Makina ndalon te semafori.
Vajza ecën te vijat e bardha.
Djali gabon.

2. Shkruaj foljen që duhet (shkruan, fle, zbukurojnë, pi).

Macja ..... mbi divan. Ana ..... në kompjuter.
Qengji ..... qumësht. Lulet ..... kopshtin.

3. Vendos foljet: bie, tregon, fryn, bien, qëndrojnë, pëlqejnë, ngroh, **në vendin e duhur.**

Jashtë ..... shi. Era ..... me tërbim. Gjethet ..... nga pemët. Një radiator i madh ..... dhomën. Fëmijët ..... pranë gjyshes. Ajo u ..... një përrallë të bukur. Fëmijët e ..... shumë përrallën.

PËRSHKRUAJ DIMRIN

1. Çka di ti për urithët? Ku jetojnë ata? Trego diçka interesante.
2. Vendos numra në kuti, për t'i renditur si duhet pjesët e përrallës.

Lulina në dimër

☐ Papritmas filloi të binte borë. Flokët e borës iu dukën si gjethe të bardha, sepse ishte përgjumësh.

☐ Pas pak minutash e zuri përsëri gjumi dhe filloi të shihte ëndrra me fusha të lulëzuara pranverore.

☐ Lulina flinte prej disa javësh në shtëpinë e saj nën tokë.

☐ – Sa ftohtë! Nuk kam dëshirë fare të dal jashtë. Do të shtrihem sërish të fle. Dhe Lulina u kthye në krahun tjetër për të fjetur.

☐ Kur u zgjua, ishte dimër, por ajo nuk kishte vënë re asgjë. Mendoi se mos ishte vjeshtë. Po prapë iu duk shumë ftohtë.

- Shkruaje si duhet përrallën në fletore.

- Përshkruaje stinën e dimrit. Mund të përdorësh këto fjalë:

emra	*mbiemra*	*folje*
stinë	e ftohtë	erdhi
borë	i kristaltë	luaj
bredh	i bardhë	rrëshqas
gjurmë	gri	ngrin
dreri	e butë	bëj
zjarr	i nxehtë	zbardh

LEXOJMË

Ku e gjejmë ujin?

Uji nuk ka shije
dhe nuk ka as erë,
uji nuk ka ngjyrë,
por ka shumë vlerë.

Ku nuk e gjen ujin,
në ujëvarë, në lumë,
në pus e përrua,
në det, valë e shkumë.

Si male të ngrira,
në pole e gjen,
e gjen në burime,
në shi e liqen.

Edhe në fytyrë,
herët në mëngjes,
kur lan të dy faqet,
dhe të hyn në vesh.

E gjen dhe në trup,
qysh ditën kur lind,
ujë ka trupi yt,
shtatëdhjetë për qind!

Odhise Grillo (përshtatje)

Kupto tekstin

Në lëndën "Njeriu dhe natyra" do të mësosh se trupi i njeriut përmban 70% (shtatëdhjetë për qind) ujë. Pa ujë ne nuk mund të jetojmë. Prandaj, kur është tepër nxehtë, ne duhet të pimë më shumë ujë e të hamë fruta të freskëta, sepse trupi ynë ka shumë nevojë për këto lëngje.

Plotëso e shkruaj.

Uji nuk ka .....
Uji ka shumë .....
Ujin e gjejmë .....
Ujin e përdorim .....



Në cilën lëndë mësojmë ne për ujin:
në "Matematikë", në "Njeriu dhe natyra" apo në "Muzikë"?
Në cilin varg tregohet se uji ngrin në të ftohtë? .....

Detyrë. Mëso ta lexosh bukur vjershën.

UJI ËSHTË SHUMË I RËNDËSISHËM

Me siguri ke luajtur në një ditë të nxehtë vere. Sa ujë të pihet! Atëherë shkon me vrap te çezma për të mbushur një gotë të madhe me ujë. Përfytyro sikur nga rubineti të mos dalë asnjë pikë ujë.

Kur ti lan dhëmbët apo duart, nuk ke pse e mban rubinetin hapur. A e di ti që gjatë kësaj kohe mund të kursesh një kanë me ujë?
Uji bëhet shumë shpejt i papastër. Nëse ti hedh mbeturina, ai ndotet dhe e shkatërron gjithë mjedisin përreth. Kur shkon me pushime, mos i hidh asnjëherë mbeturinat e tua në det ose në liqen. Copat e vogla plastike apo letrat e aluminit mund t'i dëmtojnë kafshët që jetojnë në ujë.
Nëse duhet t'i ujitësh lulet, këtë mund ta bësh dhe me ujin e mbledhur nga larja e perimeve apo me ujin e mbledhur të shiut.
Përfytyro sikur të mos kesh ujë për t'i ujitur lulet.

Pas leximit të mësueses, plotëso këshillat e mëposhtme me fjalët e duhura.

- Kur lan dhëmbët, nuk duhet .....
- Kur shkon në bregdet, nuk duhet .....
- Lulet mund t'i ujitësh .....



Aktivitet
Vendos një gotë poshtë rubinetit. Hape rubinetin sa të pikojë. Prit pesë minuta dhe shiko sa ujë ka në gotë. Imagjino sa shumë ujë harxhohet çdo ditë nga njerëzit. Secili prej nesh mund të bëjë diçka për ta kursyer ujin. Edhe ti.

Mëso fjalë të reja

çezmë – gyp nëpër të cilin rrjedh uji i pijshëm.
kanë – enë qelqi me një dorezë për ujë.

Përralla dhe filmi

Shumë prej përrallave që ke lexuar, siç është dhe përralla ***Mbreti luan,*** ti me siguri i ke parë edhe si filma vizatimorë.
Si të janë dukur ata?

Figurat janë marrë nga përralla ***Mbreti luan***. Renditi sipas radhës së veprimeve që ndodhin në përrallë.





- [ ] Simba shkoi në xhungël, derisa u rrit.
- [ ] Xhaxhai i Simbës donte ta vriste dhe Simbën.
- [ ] Shoqja e tij, Nala, i tha se xhaxhai ishte bërë mbret.
- [ ] Luani mbret ra nga shkëmbi për të mbrojtur Simbën.
- [ ] Simba u bë mbret dhe u martua me Nalën.
- [ ] Simba luftoi dhe fitoi kundër xhaxhait dhe hienave.

Shkruaji fjalitë të renditura si duhet në fletore.

Detyrë

Zgjidh një përrallë që është bërë edhe film dhe shkruaj ndodhitë e saj sipas modelit të mësipërm.

Ushtrime për foljen

Të gjithë bëjnë diçka. Çfarë bën secili?
Vendosi foljet *kap, drejtoj, bëj* në vendet e duhura.

Piloti ..... avionin. Polici ..... trafikun. Mami .....makinën.



Peshkatari ..... peshkun. Portieri..... topin. Macja ..... miun.

Kuzhinieri ..... gjellën. Djali .....detyrat. Fëmijët ..... garë.

Zëvendësoji me folje të tjera sipas modelit.

bëj mësimet - mësoj

bëj not - .....
bëj garë - .....
bëj mësimet - .....
bëj vrap - .....
bëj punë - .....
bëj projekt -.....

1. Plotëso me folje fjalitë.

Unë ..... librin. Ti ..... një letër.

Arditi ..... balonën. Dea ..... me shoqet.

Ju .....lulet. Ne ..... pemët në kopshtin e shkollës.

2. Lidh me shigjetë dhe shkruaj fjalitë.

Miri	vjen nga puna.	.....
Ata	mbush ujë.	.....
Mami	pastrojnë oborrin.	.....
Ardita	ushqej macen.	.....
Unë	lexon shpejt	.....
Ju	kujdeseni për qenin.	.....
Peshkatari	lexon një libër me përralla.	.....
Gjyshja	zë peshk.	.....

3. Plotëso fjalinë me dy folje për secilën pyetje.

Çfarë bën nxënësi? Nxënësi lexon dhe ..... .

Çfarë bën ti në mëngjes? Unë ..... dhe ..... .

Çfarë bëni ju në klasë? Ne ..... dhe ..... .

Çfarë bën piktori? Piktori ..... dhe ..... .

Çfarë bëjnë zogjtë? Zogjtë ..... dhe ..... .

4. Plotëso me dy emra secilën folje:

P.sh.: zogu, aeroplani → fluturon

..... → ecën

..... → luan

..... → noton

Pinoku mbjell monedha

Pinoku e përqafoi i lumtur Zanën, pasi ajo e ndihmoi atë që t'i kthehej hunda e gjatë në normale. Pastaj Pinoku vrapoi në pyll që t'i dilte përpara Xhepetos. Kur po arrinte te Lisi i Madh... e dini kë takoi?

Maçokun dhe Dhelprën.

– Oh, i dashur Pinok, ç'do këtu ti? – e pyetën dy shokët.

– Është histori e gjatë. Kur më latë vetëm këtu, keqbërësit deshën të më merrnin monedhat!

– Të poshtrit! Ah, të poshtrit! – thanë ata duke tundur kokat.

– Por unë i kam ende në xhep katër monedhat! – i siguroi ai.

– Po na dëgjove ne, groposi te Fusha e Mrekullive dhe do të të bëhen një mijë, dy mijë! – tha Dhelpra. – Por duhet t'i groposësh menjëherë, sepse fusha është shitur dhe nesër do të jetë shumë vonë.

Pinokut i shkoi menjëherë mendja te baba Karloja dhe te Zana. Donte patjetër që t'u tregonte atyre mirënjohjen e tij, duke u dhuruar nga paratë që do t'i shtoheshin. Ndaj nuk e zgjati shumë dhe tha:

– Mirë, do të vij me ju.

Pas gjysmë dite rrugë, arritën në Idiotkapës, një qytet i mbushur me qen

të zgjebosur, pula pa kreshta dhe pa lafsha, flutura që kishin shitur krahët, pallonj pa bisht. Fusha e mrekullive ishte njësoj si gjithë fushat e tjera të botës. Pinoku, plot besim, hapi një gropëz, futi katër monedhat, i ujiti dhe pyeti:

– Duhet bërë ndonjë gjë tjetër?

– Kthehu pas njëzet minutash, – thanë Maçoku dhe Dhelpra.

– Ne po ikim. Jemi të lumtur që të mësuam se si mund të pasurohesh pa u lodhur fare.

Me t'u kthyer në qytet, buratini i numëroi minutat një për një. Kur mendoi se kishte vajtur ora, u nis për te Fusha e Mrekullive, duke ëndërruar për pasuri, pallate, kuaj, ushqime të shijshme. U përpoq të dallonte nga larg ndonjë pemë plot me monedha, por asgjë.

Kur mbërriti te fusha, gërmoi me shpejtësi gropën: ASGJË.

Karlo Kolodi

Kupto tekstin

Përgjigju pyetjeve

1. Çka di ti për Pinokun? Trego disa nga aventurat e tij.
2. Pse Pinoku quhet buratin?
3. Ke parë ndonjë film për Pinokun? Trego një skenë që të ka pëlqyer më shumë.
4. Pse Pinoku ishte shumë i lumtur kur u nda nga Zana?
5. Çfarë i propozuan Pinokut Dhelpra dhe Maçoku?
6. Pinoku bëri dy gabime. Cilat janë ato?

Po ti?

Nëse Pinoku do të mësonte në shkollë, a do t'i mbillte monedhat? Pse?

Përmend disa gjëra që mbillen dhe rriten.

Plotëso dhe shkruaj

Kafshët në Idiotkapës ishin:

qen të .....

pula .....

flutura .....

pallonj .....

Mëso fjalë të reja

monedhat – para prej metali.
duke tundur – duke lëvizur.
kreshtë – xhufkë puplash si kaçubë që i kanë mbi kokë pulat.
lafshë – pjesa e mishtë, zakonisht e kuqe, që e kanë mbi kokë disa shpendë.
buratin – kukull prej druri.
pallate – ndërtesa të mëdha e të larta.
gërmoj – rrëmoj.

Përshkruaj Pinokun

1. Cili është personazhi? Vendos në vendet bosh fjalët e duhura: *baba Karloja, buratin, Pinok.*

Ai quhet .....
Atë e krijoi .....
Ai është .....

2. Si e ka pamjen personazhi? Vendos në vendet bosh fjalët e duhura: të gjatë, druri, të hollë.

Pinoku është prej ..... .
Ai i ka këmbët dhe krahët ..... .
Pinoku e ka hundën shumë..... .

3. Cilat janë cilësitë e personazhit? Lidh me shigjetë:

Pinoku e do baba Karlon.	dembel
Pinokut i vjen keq për baba Karlon.	i sinqertë
Pinoku thotë të vërtetën.	gënjeshtar
Pinoku gënjen ndonjëherë.	mendjelehtë
Pinoku nuk do të mësojë.	zemërmirë
Pinoku gënjehet shpejt.	zemërbutë

Ndaji në fletore në dy shtylla:

Të mirat e Pinokut	Të metat e Pinokut

4. Çfarë sheh në këto figura? Shumë personazhe të librave janë bërë kukulla. Po ti, a ke të tilla?

Detyrë. Përshkruaj një kukull që të pëlqen më shumë.

Princesha mbi bizele



Na ishte njëherë një princ. Ai donte të martohej me një princeshë. Princi i ra botës rreth e përqark, po nuk e gjeti dot princeshën. Jo se nuk kishte. Por princi nuk i besonte asnjë vajze që i thoshte se ishte princeshë. Mbreti dhe mbretëresha u mërzitën shumë.

Një natë nisi një stuhi e madhe. Dikush trokiti në portën e kështjellës mbretërore. Jashtë portës ishte një vajzë e qullur nga shiu dhe me rroba të vjetra. Ajo i tha mbretëreshës se ishte princeshë. Po askush nuk i besoi.

– E di unë se ç'do të bëj, – mendoi mbretëresha dhe nuk i tha askujt për këtë gjë.

Shkoi në dhomën e miqve dhe vuri një bizele në shtrat. Mbi shtrat vuri shumë dyshekë dhe të butë. Në këtë shtrat fjeti vajza e panjohur.

Në mëngjes mbretëresha e pyeti princeshën se si kishte fjetur.

– Nuk kam mbyllur sy gjithë natën, – u përgjigj vajza. – Nuk e di se çfarë kishte në shtrat, pikërisht këtu nën shpatull. Më dhemb shpina.

Atëherë mbretëresha i besoi se vajza ishte një princeshë e vërtetë. Ajo ishte mësuar të flinte në shtrat të butë.

Princi u martua menjëherë me vajzën. Ndërsa bizelen e ruajtën në dhomën e thesareve.

Hans K. Andersen

Kupto tekstin

Mëso fjalë të reja

stuhi - erë e madhe me shi të rrëmbyer, me breshër e me borë të dendur.
e qullur - e lagur shumë.
e panjohur - që nuk e njeh askush.
nuk kam mbyllur sy - nuk kam fjetur fare.
dhoma e thesareve - dhoma ku mbreti ruan pasurinë dhe sendet me vlerë.

Përgjigju pyetjeve

1. Pse princi e shëtiti botën rreth e përqark?
2. Kush trokiti në portën e kështjellës natën me stuhi?
3. A i besoi ndokush vajzës, kur tha se ishte princeshë?
4. Çka bëri mbretëresha?
5. Pse vajza nuk kishte fjetur gjithë natën?
6. A u martua princi me vajzën? Pse?

Shëno me ✓ përgjigjen e saktë dhe ✘ përgjigjen e gabuar:

- ☐ Princi donte të martohej me një vajzë të thjeshtë.
- ☐ Vajza trokiti në portën e kështjellës në mëngjes.
- ☐ Mbretëresha nuk i tregoi askujt për planin e saj.
- ☐ Vajza fjeti rehat gjithë natën.
- ☐ Mbretëresha nuk i besoi në mëngjes vajzës.
- ☐ Princi u martua me vajzën.
- ☐ Vajza ishte një princeshë e vërtetë.

Bisedojmë për përrallën

"Princesha mbi bizele" është një nga përrallat më të njohura dhe më të pëlqyera në të gjithë botën. Shkrimtari Andersen do të na tregojë se jo gjithnjë pamja tregon atë që është e vërtetë. Vajza nuk ishte ashtu si dukej, por e rritur me shumë përkujdesje dhe dashuri nga prindërit.

- A tha ajo të vërtetën? Çfarë cilësie e vajzës del në këtë përrallë?

Në përralla ndodhin veprime të çuditshme e të pabesueshme, si në rastin e kokrrës së bizeles poshtë dyshekut.

- A ndodh në realitet kjo gjë? Pse?

Si ndërtohet përralla?

Shiko në figurë se si ndërtohet përralla.

Shkruaj shkurt në Fletoren e punës përrallën "Princesha mbi bizele".
Plotëso vendet bosh me fjalët e duhura.

Titulli — Princesha mbi bizele

Hyrja e përrallës — Na ishte njëherë .....
Ai donte të martohej me një.....

Brendia e përrallës — Vajza trokiti në .....
Mbretëresha i vuri në shtrat .....
Vajza nuk fjeti gjithë.....

Fundi i përrallës — Princi u martua .....
.....e ruajnë në thesaret e mbretërisë.

Kujto përrallën "Borëbardha dhe shtatë xhuxhët". **Shkruaj sipas shembullit të mësipërm:**

Titulli
Hyrja (dy fjali)
Brendia (tri fjali)
Mbyllja (dy fjali)

Përdor këto fjalë:

Na ishte njëherë; mbretëresha lindi;
mbretëresha vdiq; njerka shpirtligë;
e përzuri nga pallati; shkoi në pyll;
në shtëpinë e shtatë xhuxhëve;
u bë si plakë; molla e helmuar;
e gjetën pa frymë; princi e puthi;
hapi sytë; jetuan të lumtur.

Kush jam unë

Përshkruaj veten.

Përgjigju me shkrim pyetjeve në fletore.

Autoportreti



Kush jam unë?
- Si quhem?
- Sa vjeçe jam?
- Ku banoj?
- Në cilën shkollë mësoj?

Si dukem unë?
- Çfarë ngjyre i kam sytë?
- Si i kam flokët?
- Jam e gjatë, mesatare apo e shkurtër?
- Jam e shëndoshë, mesatare apo e dobët?

Si jam unë?
- Si shkoj me mësime?
- Cila lojë më pëlqen më shumë?
- A më pëlqen muzika, vizatimi etj.?
- Si shkoj me shokët?
- Çka dëshiroj të bëhem kur të rritem?

• Përshkruaj veten duke e krahasuar me cilësi të kafshëve: *bleta, tigri, luani, lepurushi, qengji, kërmilli, majmuni.*

Jam trim / trime si .....
Jam i butë / e butë si .....
Jam i urtë / e urtë si .....
Jam i egër / e egër si .....
Jam punëtor / punëtore si .....
Jam i shkathët / e shkathët si .....
Jam i ngadalshëm / e ngadalshme si .....

UNË JAM, TI JE...

Unë jam Vesa.

Ti je Lesi.

Ai është babi im.
Aio është nëna ime.

Ne jemi një familje.

Ju jeni shokët e mi.

Ata janë shokët e tu.

Fjala *jam* është folje. Ajo tregon *kush jam*, *si jam*, *ku jam*, *çfarë jam* etj. Folja ndryshon sipas vetës.

USHTROHU

1. Lidh me shigjetë.

Ju	jam Beni.
Ato	je Albani.
Ajo	është Miri.
Ata	është Luljeta.
Ne	jemi shokë.
Unë	jeni vëllezër.
Ti	janë motra.
Ai	janë vëlla e motër.

2. Vendos foljen jam në vendet me pika.

Unë ..... në klasën e dytë.
Ai ..... në klasën e pestë.
Ne .....në klasën e tretë.
Ata .....në kopsht.
Ti .....në shkollën e mesme.
Ju .....në universitet.
Ajo.....në klasën e nëntë.
Ato.....në klasën e parë.

3. Shkruaj si duhet foljen jam në fjalitë e mëposhtme:

Unë .....nga fshati. Ndërsa ti.....nga qyteti. Shoku im.....nga bregdeti. Shoqja ime.....nga një vend malor. Djemtë.....në këndin sportiv. Vajzat.....me mësuesen e muzikës. Ne.....në rrethin e pikturës. Ju.....tani këtu me ne.

a. Unë **jam** këtu. Po ti, **ku je**?

Shkruaj si duhet foljen jam.

Unë jam në shtëpi.
Ju ..... në bibliotekë.
Motra ..... në shkollë.
Ne ..... në pishinë.
Babi ..... në punë.
Fëmijët ..... në palestër.
Mësueset ..... në oborrin e shkollës.
Ti ..... te lodrat.

b. Unë **jam** shqiptar**.** Po ti, **çfarë je**?

Shkruaje si duhet foljen jam **dhe shkruaj pyetjen sipas modelit.**

Unë jam italian.	Çfarë je ti?
Vëllai ..... nxënës.	.....
Motrat e tua ..... sportiste.	.....
Prindërit ..... biznesmenë.	.....
Ti ..... kujdestare.	.....

c. Unë **jam i mirë**. Po ti, **si je**?

Shkruaje si duhet foljen jam dhe shkruaj pyetjen sipas modelit.

Ne jemi kureshtarë.	Si jemi ne?
Ata ..... guximtarë.	.....
Ti ..... i shkathët.	.....
Ajo ..... e bukur.	.....
Ai ..... i gjatë.	.....
Ato ..... interesante.	.....

Shkruaj përemrin vetor që duhet.

..... jam kampion në basketboll.
..... je kampion në futboll.
..... është alpinist i zoti.
..... jeni ekipi më i mirë i shkollës.
..... janë kundërshtarët tanë.
..... është atlete shumë e mirë.

A KE NDONJË SEKRET?

Cilat janë sekretet e mira?

Sekretet e mira të bëjnë shumë të lumtur ty dhe njerëzit rreth teje.

Cilat janë sekretet e këqija?

Sekretet e këqija të bëjnë të ndihesh shumë keq; të mërzitin e të shqetësojnë shumë.

Është sekret i mirë apo i keq?
Ti i bën surprizë një dhuratë motrës ose vëllait, shoqes ose shokut. Sa gëzohen ata kur ti thërret: SURPRIZË!

Është sekret i mirë apo i keq?
Ti ke një përshëndetje të veçantë, që e shkëmben vetëm me shokun e ngushtë.

Mëso fjalë të reja

sekret - diçka që mbahet e fshehtë.

surprizë - diçka që ndodh kur nuk e presim.

Është sekret i mirë apo i keq?
Ti luan kukafshehtas dhe e ndihmon shokun e ngushtë të gjejë një vend të mirë.

Është sekret i mirë apo i keq?
Në darkë ty të pëlqen të flesh me arushin, sepse ndonjëherë ke frikë dhe me të ndihesh më i sigurt.

Është sekret i mirë apo i keq?
Një fëmijë i rritur ia merr paratë një fëmije më të vogël.

Është sekret i mirë apo i keq?
Një i rritur i panjohur të fton të shkosh për të luajtur në shtëpinë e tij ose të shëtisësh me makinën e tij. A duhet të shkosh me të? JO. A duhet t'i tregosh mamit ose babit për këtë gjë? Patjetër që PO. Dikush të godet shpesh, të shtyn ose të shkelmon dhe të frikëson duke të thënë: "Mos guxo të tregosh!". Ndonjëherë të duket e vështirë të flasësh me një të rritur për këto gjëra. Por duhet ta bësh.

BËHU I GUXIMSHËM! BËHU E GUXIMSHME!

Duhet të flasësh me një njeri të cilit ti i beson. Mund të jetë mami ose babi, halla, tezja, daja ose axha, mësuesi ose mësuesja në shkollë. Të tregosh një sekret të keq, është gjëja më e mirë që mund të bësh.

Piktura më e bukur

Në bebëzat e mësueses
më e ndritshmja dritë,
cicërimat e zogjve
në buzët e saj...

Ditari i heshtur mbi tryezë,
manushaqet e para në gotë,
piktura më e bukur në botë.

Rifat Kukaj

Kupto tekstin

Përgjigju pyetjeve

1. Mësuesja është e gëzuar apo e mërzitur?
Lexo vargjet që e tregojnë këtë.
2. Mësuesja po buzëqesh apo po i shan fëmijët?
Lexo vargjet që e tregojnë këtë.

Plotëso dhe shkruaj

1. Çfarë ka në pikturën për mësuesen?
   një luleborë ☐
   një manushaqe ☐
   një regjistër ☐
   një ditar ☐

2. Plotëso vendet bosh me fjalët e duhura: *e dashur, të lumtur, e gëzueshme, me ujë, e freskët.*

   Cicërimë .....
   Mësuese .....
   Nxënës .....
   Lule .....
   Gotë .....

3. Mëso ta lexosh bukur vjershën.

Nënës

Puthjen e parë,
nënës.

Lulen e parë,
nënës.

Vizatimin e parë,
nënës.

Letrën e parë,
nënës.

Të fshehtën e parë,
nënës.

Se nëna më lindi,
mua në maj.

Dhe askush tjetër,
s'më lindi përveç saj.

Agim Deva

Kupto tekstin

Përgjigju pyetjeve

1. Po ti si mendon, pse të gjithë fëmijët ia japin nënës:
   puthjen e parë,
   lulen e parë,
   vizatimin e parë,
   letrën e parë,
   të fshehtën e parë?

2. Mamin unë e dua, sepse:
- më ka mbajtur nëntë muaj në barkun e saj;
- më ka ushqyer me qumështin e saj;
- kujdeset për.....

Shto dhe ti disa gjëra të tjera.

3. Njërën nga dy vjershat mësoje përmendsh.

Poezi për mamin dhe mësuesen

Vendos fjalët e duhura në vargje.

guaska

zogj

flutura

bletë

kokrriza rëre

pikla vese

Ka vetëm një nënë
Miliona <u>yje</u> në qiell,
Miliona ..... ka në det,
Miliona ..... këndojnë si fyej,
Miliona ..... gjen në bregdet.

Miliona ..... mëngjesin freskojnë,
Miliona ..... mbledhin <u>nektar</u>,
Miliona ..... në fusha vallëzojnë,
Po vetëm një nënë në botë ka.
Përshtati: Odhise Grillo

Lexo vjershat dhe shkruaji në rreshta, që të ngjajnë me një përshkrim. Shto fjalë të tjera.

Mami
Mami im është
një engjëll.
E bardhë dhe e butë,
e ëmbël si një tortë
prej çokollate.
E lehtë si
një pupël,
që kërcen në livadh.
E bukur si një lule,
që më përqafon
e më shtrëngon
me shumë dashuri,
kur në krahët e saj më çon.
Elena, 7 vjeç

Mëso fjalë të reja

nektar - lëng i ëmbël i luleve që e thithin bletët për të bërë mjaltin.

Për dore
Një nënë me fëmijën e saj shkon
dorë për dore, drejt një rruge të
ëmbël e çon:
derisa zogu vetë të fluturojë,
derisa fëmija vetë në jetë të shkojë.
R. Guarnieri

1. *Mami është si një engjëll, ... Mami është e ëmbël ....*
.....
.....
.....
2. .....
.....
.....

PARA, TANI, PAS

1. Vendos në vendin e duhur fjalët: darkë, mëngjes, drekë.

Më parë ishte.....

Tani është.....

Pastaj do të jetë.....

2. Vendos në vendin e duhur fjalët: data 8, data 9, data 7.

Mars						
H	M	M	E	P	SH	D
	1	2	3	4	5	6
(7)	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

Dje ishte.....

Mars						
H	M	M	E	P	SH	D
	1	2	3	4	5	6
7	(8)	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

Sot është.....

Mars						
H	M	M	E	P	SH	D
	1	2	3	4	5	6
7	8	(9)	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

Nesër do të jetë.....

Përgjigju me gojë:

1. Cili muaj ishte para janarit?
2. Cili muaj do të jetë pas shkurtit?
3. Cili muaj është tani?
4. Cili muaj ishte më parë?
5. Cili muaj do të jetë më pas?
6. Cila stinë ishte para dimrit?
7. Cila stinë do të jetë pas dimrit?

- Ushtrohu duke pyetur shokun. Fiton ai që s'bën gabime.

Përgjigju me shkrim:

1. Cila ditë është para së hënës? — Para së hënës është e diela.
2. Cila ditë do të jetë pas së hënës? — .....
3. Cila ditë është sot? — .....
4. Cila ditë ishte dje? — .....
5. Cila ditë do të jetë nesër? — .....

Vendos fjalët: *më parë, tani, nesër, më parë, më vonë, tani, vitin e ardhshëm, më parë, dje,* **në vendet bosh.**

..... ne shkonim në kopsht. ..... ne mësojmë në klasën e dytë. .... ne do të shkojmë në klasën e tretë. ..... ne nuk lexonim vetë. Atëherë librat na i lexonin më të rriturit. ..... ne lexojmë vetë. ..... Dritani po i lexonte motrës një përrallë.

Mësuesja e madhe Natyrë

1. Atë mëngjes Lulja u zgjua herët. Nga dritarja ajo pa qiellin e kaltër si pasqyrë. Zemra iu mbush plot gëzim.

2. Pas pak, prapa malit, dielli nxori syrin e tij të zjarrtë. Një rreze i ra Lules në sy. Ajo e pyeti:

– Pse qenke ngritur kaq herët, o Diell?

– Unë ngrihem gjithmonë herët, që t'i jap dritë Tokës dhe jetë bimëve e njerëzve.

3. Në atë çast kaloi me shpejtësi një dallëndyshe me një fije kashte në gojë.

– Qëndro pakëz e më thuaj, pse nxiton kështu kaq herët, moj dallëndyshe?

– Nxitoj, se dua të bëj folenë e re ku të rris zogjtë.

4. Pas dallëndyshes kaloi një bletë.

– Pa ndalu pakëz, moj bletë e dashur. Më trego, ç'kërkon kaq herët këtu në lulishte!

– S'kam kohë të qëndroj, vogëlushe, se dua të marr nektarin nga lulet dhe të bëj me të mjaltin.

5. – Të gjithë punojnë, – thirri Lulja, – prandaj edhe unë do të punoj dhe do të mësoj më shumë.

– Të faleminderit, o Natyrë, që më mësove kaq shumë gjëra sot!

Naim Frashëri

Kupto tekstin

Përgjigju pyetjeve

1. Çfarë pa Lulja nga dritarja?
2. Për çka e pyeti Lulja Diellin?
3. Çka i tha Dielli?
4. Pse nuk qëndroi dallëndyshja?
5. Pse bleta kishte shkuar në kopsht?
6. Pse e falënderoi Lulja Natyrën?

Shëno me ✓ përgjigjen e saktë dhe ✘ përgjigjen e gabuar.

Lulja u ngrit vonë. ☐
Rrezja i ra Lules në sy. ☐
Dielli ngrihet herët në mëngjes. ☐
Dallëndyshja do të ushqente zogjtë në fole. ☐
Bleta do të merrte nektarin. ☐
Natyra nuk i mësoi shumë gjëra Lules. ☐
Lulja nuk i tha asgjë Natyrës. ☐

Lidh me shigjetë

Dallëndyshja	i jep dritë Tokës.
Bleta	i mbron pemët nga krimbat.
Dielli	u mëson njerëzve shumë gjëra.
Natyra	e ndërton folenë për zogjtë.
Qukapiku	e thith nektarin dhe bën mjaltë.

Shkruaj përmbledhjen e pjesës me pesë fjali duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve:

1. Kur u ngrit Lulja?
2. Çfarë po bënte Dielli?
3. Çfarë po bënte dallëndyshja?
4. Çfarë po bënte bleta?
5. Çfarë i tha Lulja Natyrës?

Gjinkalla dhe milingona



Një gjinkallë shkoi njëherë te një milingonë në mes të dimrit dhe i tha:

– Më jep diçka nga gjithë këto që ke mbledhur dhe ke mbushur folenë. Unë s'kam ç'të ha në këtë kohë të keqe dhe do të vdes nga uria.

– Po ti ç'bëje në verë, – e pyeti milingona, – kur unë shkoja lëmë më lëmë për të mbledhur këto kokrra e këto fije byku?

– Unë atëherë lodroja e ia thosha këngës, – iu përgjigj gjinkalla.

– Po meqë këndoje atëherë, kërce tani! – tha milingona dhe i ktheu krahët.

Sami Frashëri (përshtatje)

KUPTO TEKSTIN

Përgjigju pyetjeve

1. Ç'kohë ishte kur gjinkalla shkoi te milingona
   - ☐ verë
   - ☐ pranverë
   - ☐ vjeshtë
   - ☐ dimër?
2. Çka i kërkoi gjinkalla milingonës?
3. Pse milingona kishte mbledhur shumë ushqime?
4. Çka bënin në verë:
   milingona gjinkalla?
5. Pse milingona ia ktheu krahët gjinkallës? Zgjidh:
   - ☐ ishte e keqe
   - ☐ ishte zemërngushtë
   - ☐ ishte e drejtë.

6. Lexo me zë të lartë fjalinë me të cilën mbaron kjo përrallë.

- Çfarë mëson nga ajo?
- Po ti, a di ta ndash kohën e mësimit nga koha e lojës?
- A të ndodh ndonjë ditë që të luash gjithë pasditen?
- A është gjë e mirë kjo?
- Si e kupton mësimin e përrallës?

Mëso fjalë të reja

lëmë - lëmi, shesh ku mblidhet gruri, thekra etj., dhe nxirret kokrra nga kalliri.
byku - kashtë e imët dhe e copëtuar, që mbetet nga kalliri.

NDARJA E FJALËVE NË FUND TË RRESHTIT

Motra dhe vëllai po përshkruajnë njëri-tjetrin. Si i kanë ndarë ata fjalët në fund të rreshtit?

• Cilat fjalë i kanë ndarë mirë fëmijët? Ngjyrosi. Po fjalët e tjera pse nuk i kanë ndarë mirë?

Mbaj mend! Kur nuk ka vend në fund të rreshtit, fjalën e ndajmë në dy pjesë.
Ka disa rregulla se si ndahen fjalët në fund të rreshtit.

• Fjalët ndahen sipas rrokjeve.

di-ta; pe-ma; li-moni ose **limo-ni; dri-tare** ose **drita-re; trënda-fili** ose **trë-ndafili**

• Shkronjat dyshe dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh etj., nuk ndahen asnjëherë nga njëra-tjetra:

~~thas-hë~~ ~~mal-li~~ ~~pas-hë~~, por **tha-shë, ma-lli, pa-shë**

• Fjalët njërrokëshe nuk ndahen asnjëherë në fund të rreshtit:

~~li-s~~, ~~de-t~~, ~~n-ën~~, ~~m-bi~~ etj.

• Në fund e në fillim të rreshtit tjetër nuk lihet asnjëherë një shkronjë e vetme, qoftë kjo edhe zanore:

~~la-u~~, ~~er-ë~~, ~~e-rë~~, ~~shko-i~~, ~~mi-u~~, ~~u-në~~, ~~ur-ë~~ etj.

USHTROHU

1. Ndaji fjalët në rrokje, siç do t'i ndaje në fund të rreshtit.

shkumës	.....	kukull	.....
pema	.....	lisi	.....
peshku	.....	breshka	.....

2. Ndaji në dy mënyra fjalët në fund të rreshtit.

peshkatar	pe-shkatar	peshka-tar
përrallë	.....	.....
tekniku	.....	.....

3. Ndaji në tri mënyra fjalët në fund të rreshtit.

televizori	televizo-ri	televi-zori	tele-vizori
xixëllonja	.....	.....	.....
portokalli	.....	.....	.....

4. Shëno me ✓ fjalët e ndara mirë dhe me ✘ fjalët e ndara gabim.

☐ limo – ni	☐ shko - lla	☐ shar - ra
☐ u - ra	☐ mac - ja	☐ më - suesi
☐ pël - lumbi	☐ lo - pata	☐ sheg - a

5. Plotëso rrokjet që mungojnë te fjalët e mëposhtme. Në kutitë bosh vendos numrin e rrokjeve.

☐ ma -	☐ ba - .... - ne	☐ xi - .... - llo - ....
☐ do -	☐ ma - ki -	☐ mi - .... - ngo - .....
☐ mje -	☐ fla - ..... - ri	☐ te - le - .... - ni

Detyrë. Ndaj në fund të rreshtit fjalët: aeroplani, gorrilla, shqiponja, enciklopedia, lis.

Krahasojmë kafshët e fabulave

- Plotëso etiketat me cilësitë e secilës kafshë.

i shpejtë | dembel | e mençur | e urtë | e ngadalshme | mendjelehtë



Cilësitë e mira peshojnë më shumë se cilësitë jo të mira.

- Cila anë e peshores rëndon më shumë? Pse?

- Vendos në peshore (në fletoren e punës) etiketat me:
  cilësitë e ujkut dhe të kecave,
  cilësitë e shtrigës dhe të Borëbardhës.

Përdor këta mbiemra:

i fortë, e keqe, i egër, e bukur, të dobët, e shëmtuar, budalla, punëtore, të mençur, e dashur, dinake, të vegjël.

Bëj një vizatim të garës së breshkës me lepurin. Shëno vendin ku ata do të nisen dhe vendin ku do të mbërrijnë. Pastaj vizato rrugën e gjatë dhe lepurin prapa breshkës.

Shkruaj në etiketa:

Vendi i nisjes

Rruga e garës

Vendi i mbërritjes

Ngjiti ato në vizatim.
Festoje dhe ti fitoren e breshkës me "Urra!".

DJE ISHA..., NESËR DO TË JEM...

Vjet unë isha në klasën e parë.
Vjet ti ishe në klasën e dytë.
Vjet ai/ajo ishte në klasën e tretë.

Vitin tjetër unë do të jem .....
Vitin tjetër ti do të jesh .....
Vitin tjetër ai/ajo do të jetë.....

Vjet ne ishim në katin e parë.
Vjet ju ishit në katin e dytë.
Vjet ata/ato ishin në katin e tretë.

Vitin tjetër ne do të jemi .....
Vitin tjetër ju do të jeni .....
Edhe vitin tjetër ata/ato do të jenë .....

USHTROHU

1. Shkruaj si duhet foljen jam.

Dje unë.....në ekskursion.
Sot unë.....në shtëpi.
Nesër unë.....në kinema.

Vjet ne ..... 6 vjeç.
Sivjet ne ..... 7 vjeç.
Vitin tjetër ne ..... 8 vjeç.

Në mëngjes ti.....në shkollë.
Tani ti ....në shtëpi.
Pasdite ti.....në teatër.

Një orë më parë ju.....me mësuesen.
Tani ju .....me ne.
Më vonë ju.....me prindërit.

Pak më parë ai.....në klasë.
Tani ai.....në korridor.
Pastaj ai .....në oborr.

Para ca ditësh ata.....atje.
Tani vajzat ..... këtu.
Mbas ca ditësh.....përsëri atje.

2. Shkruaj si duhet foljen në kllapa.

Dje unë (jam) ..... në parkun e lodrave. Edhe vëllai im (do të jetë) ..... dje atje. Ti (je) ..... pardje në këndin sportiv. Ata (ishin) ..... nesër në këndin sportiv. Ai (ishte) ..... pas tri ditësh atje. Ju (ishit) ..... tani me provime. Pas disa ditësh ju (jeni) ..... me pushime. Ato (janë) ..... para ca ditësh në bibliotekë.

UNË KAM, TI KE...

Unë kam syze noti.

Ti ke syze dielli.

Ai ka kapelë.

Ajo ka fjongo.

Ne kemi raketa ping-pongu.

Ju keni raketa tenisi.

Ata kanë balonë.

Fjala kam është folje. Ajo tregon çfarë ke ti. Folja kam ndryshon sipas vetës.

Plotëso fjalitë me foljen kam.

Unë ..... një violinë.
Ti ..... një kitarë.
Ai/ajo ..... një daulle.
Ne ..... dy violina.
Ju ..... dy kitara.
Ata/ato ..... dy daulle.
Ejani, bëjmë një orkestër!

Unë kam zë të bukur.
Ti ke zë të bukur.
Ai/ajo ka zë të bukur.
Ne .....
.....
.....
Ejani, bëjmë një kor!

1. Shkruaj përemrat e duhur: unë, ti, ai/ajo, ne, ju, ata/ato **në vendin e duhur.**

..... ke një lepur të butë.
..... ka një gëzof të bukur.
..... keni një shtëpi prej druri në mal.
..... kam një bluzë të trashë.
..... kemi një shtëpi të madhe në fshat.
..... kanë një fermë të madhe.

• Shkruaji fjalitë në fletore sipas vetës (unë, ti...).

2. Vendos foljen kam ashtu si duhet në fjalitë e mëposhtme:

Ai ..... një lepur. Ata ..... peshq të kuq. Ju ..... një qen të madh. Ti ..... një miush të bardhë. Ne ..... pëllumba. Unë ..... një gjel dhe disa pula.

3. Vendos përemrin vetor para foljes:

..... ke ditëlindjen. ..... ka mbledhje.
..... kam stërvitje. ..... keni festë.
..... kemi shfaqje. ..... kanë takim.

4. Shkruaj si duhet foljet në kllapa.

Unë (kemi) ..... kukull që flet, ndërsa ti (ka) ..... makinë me bateri. Ne (keni) ..... kompletin e kukullës Barbi. Ju (kanë) ..... lodra elektronike. Ata (ka) ..... tullumbace me ngjyra. Ana (ka) ..... shumë vazo me lule. Ne të gjithë (kanë) ..... gjëra shumë të bukura.

5. Shkruaj si duhet foljet jam dhe kam në fjalitë e mëposhtme:

P.sh.: Unë jam nxënës. → Unë kam shumë dëshira.

Unë ..... nxënës. Unë ..... çantë.
Ne ..... djem. Ne ..... topa.
Ti ..... mjek. Ti ..... makinë.
Ju ..... vajza. Ju ..... kukulla.
Zogu ..... shpend. Ai ..... krahë.
Iriqi ..... kafshë. Ai ..... gjemba.
Ata ..... peshq. Ata ..... luspa.

Dje kisha. Nesër do të kem

Unë **kisha** një biçikletë të vogël.

Unë **do të kem** një biçikletë të re.

Ti **kishe** një peshk të verdhë.

Ti **do të kesh** një peshk të kuq.

Vazoja **kishte** dy lule.

Vazoja **do të ketë** shumë lule.

Plotëso *(kishim, do të keni, kishin, kishit, do të kemi, do të kenë)*.

Ne ..... kompjuter.
Ju ..... një këmbë sportiv.
Ata/ato ..... një balonë.

Ne ..... kompjuter të ri.
Ju ..... një këmbë sportiv të ri.
Ata/ato ..... shumë balona.

Ushtrohu



1. Lidh me shigjetë.

Unë	kishte fletore vizatimi.
Ti	kishit bojëra uji.
Ai/ajo	kisha fletore me kuti.
Ne	kishin bllok shënimesh.
Ju	kishim lapsa me ngjyra.
Ata/ato	kishe fletore me vija.

Unë	do të ketë një mësuese tjetër.
Ti	do të keni shokë të rinj.
Ai/ajo	do të kem një vëlla.
Ne	do të kenë një kinema të re.
Ju	do të kemi një makinë të kaltër.
Ata/ato	do të kesh një motër.

2. Vendos si duhet foljen kisha në fjalitë e mëposhtme.

Mami im ..... një ditar.
Vëllai dhe babi .....një kuti shahu.
Ti ..... një fustan me pika.
Unë .....një tren me bateri.
Ne ..... një banesë të vogël.
Ju ..... një shtëpi në fshat.

3. Vendos si duhet foljen do të kem në fjalitë e mëposhtme.

Unë ..... një top.
Ti ..... patina.
Ai ..... konkurs.
Ajo ..... një libër.
Ne ..... disa topa.
Ju ..... koncert.
Ata ..... disa makina.
Ato ..... disa kukulla.

4. Vendos si duhet foljen do të kem në fjalitë e mëposhtme.

Babi im ..... një punë të re.
Ti ..... një fustan.
Unë .....libër me tregime.
Fëmijët ..... plot shokë e shoqe.
Ju ..... veshje sportive.
Ne ..... një shesh lojërash.

ZHURMAT E QYTETIT

1. Plotësoni fjalët që mungojnë në tekstin e mëposhtëm.

Jam në krevatin tim dhe po më vjen gjumë, kur dëgjoj ..... që vijnë nga brenda dhe nga jashtë shtëpisë sime.
Dëgjoj makinat që u bien ....., kondicionerin që punon. Më pas dëgjoj ..... e gazetës, që po lexon mami.
Më në fund bie ....., e cila ndërpritet nga zhurma e shpifur e një .... që largohet dhe në dhomën time bie sërish qetësia.
Por ja, dëgjoj ..... që hapet. Macja Kika u kthye në shtëpi dhe po shtyn derën e dhomës sime.
Shtrihet te këmbët e mia dhe më në fund më zë gjumi me ..... e saj të ëmbla.



2. Shëtitje nëpër qytet

Zbulo tingujt që mund të dëgjosh në qytet. Lidh tingujt me mjetet e udhëtimit.

Përgjatë rrugëve të mbushura:
udhëtojnë kamionët:
kalojnë autobusët:
një makinë frenon:
dëgjon një fishkëllimë të mprehtë të bilbilit të policit:
sirena e zjarrfikëses që bën:

shshsh
rrrrrr
piiip
prrrr
pa-pi-pa-pi

3. Përshkruaj zhurmat që dëgjon natën ose kur shkon në shkollë.

Qyteti dhe rregullat



1. – Gjithmonë të rriturit na mbushin me rregulla: bëj këtë, bëj atë... Në shtëpi rregulla, në shkollë rregulla, rrugës rregulla. Po për çfarë shërbejnë ato? – Kështu ankoheni ju fëmijët gjithnjë.

Nëse në qytet nuk do të kishte rregulla, e imagjinoni sa rreziqe dhe aksidente do të kishte rrugës? Në qytezën e gjyshërve të mi kalojnë shumë pak makina dhe fëmijët mund të luajnë në shesh ose në rrugë. Ndërsa te qyteti ku banoj unë, duhet të dal patjetër me prindërit në park, që të mund të luaj.

Rregullat janë shumë të rëndësishme. Edhe për të bërë një lojë, nevojitet të ndiqen disa rregulla. Nëse secili bën çka të dojë, nuk mbaron as edhe një lojë. Gjyshi im thotë gjithmonë se rregullat të ndihmojnë të ndihesh mirë, kur shoqërohesh me të tjerët.

Kupto tekstin

Mëso fjalë të reja

qytezë – një qytet i vogël në krahasim me qytetet e mëdha.

Përgjigju pyetjeve

1. A je ti një fëmijë qyteze apo qyteti? Ku luan ti: jashtë, pranë shtëpisë apo në park?
2. Apo duhet të shkosh diku më larg i shoqëruar nga dikush më i rritur?
3. Ku do të të pëlqente të luaje?

• Përshkruaj vendin ku ti luan me shokët e tu.

Plotëso dhe shkruaj

• Shkruaj të paktën tri rregulla që të japin prindërit kur del për të luajtur.

.....

.....

.....

2. Mua më pëlqen të bëj shëtitje me biçikletë. Kur është kohë e bukur, bëj disa xhiro përpara shtëpisë sime.

Një herë kam frenuar shumë keq. Në rrugë mbetën shenjat e rrotave dhe unë gati u rrëzova.

Duhet të kemi kujdes, që të mos frenojmë shumë fort, sepse rrezikojmë të rrëzohemi nga biçikleta. Kam vënë re disa çiklistë që i japin biçikletës të përkulur për të prerë ajrin. Nëse nuk do të përkuleshin, ajri do t'u kalonte përpara trupit, duke i penguar.

Përgjigju pyetjeve

Çfarë këshillash jep autori që të ecim të sigurt me biçikletë?
Si quhen disa nga pjesët kryesore të biçikletës?
Për çfarë shërbejnë frenat?

Tini dhe Tani

Tini dhe Tani janë dy shokë,
që ecin në rrugë pa çarë kokë,
s'ka shenja për këta çamarrokë,
nuk ka as tabelë STOP.

Ej, Tini dhe Tani, mblidhni mendjen,
Në rrugë ka rreziqe shumë,
Por, nëse rregullat i ndiqni mirë,
veten mbroni
dhe të tjerët nuk i rrezikoni.

Mëso fjalë të reja

mblidhni mendjen
– kini kujdes, jini të vëmendshëm.

• Mësoje vjershën përmendsh, nëse mundesh.

Të sigurt në rrugë

Çdo pasdite Miri kthehet nga shkolla me gjyshen e tij. Rrugës ka shumë trafik. Për të mos rrezikuar, ai dhe gjyshja i zbatojnë rregullat e komunikacionit.

Ata janë këmbësorë dhe duhet të ecin në trotuar. Kur duhet të kalojë rrugën, Miri gjithmonë ia kap dorën gjyshes dhe qëndron në skaj të trotuarit, në një vend nga ku mund ta shikojë mirë rrugën. Ai dhe gjyshja shikojnë mirë në të majtë dhe në të djathtë. Kur nuk ka lëvizje, kalojnë rrugën, por pa vrapuar.

Edhe kur ka semafor ose vija të bardha, duhet të kemi shumë kujdes.

Jo të gjithë shoferët ndalojnë, edhe pse duhet ta bëjnë.

Shiko figurat dhe plotëso fjalinë.





Për të kaluar rrugën, duhet të shkojmë te .....

.....

Për të kaluar rrugën, duhet të shikojmë .....

.....

Për të ecur në vija të bardha, duhet gjithmonë .....

.....

Kur duhet të kalojmë në vija të bardha, nuk duhet .....

.....

Kujto se, kur ka vija të bardha, duhet të shikosh mirë nga e djathta dhe nga e majta, pastaj të kalosh rrugën pa vrapuar.

KUJDES SJELLJET!

Shiko figurat dhe përgjigju me shkrim.

Pse janë të gabuara këto sjellje?







.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Si sillesh, kur je në makinë me të rriturit?

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

UNË LEXOJ... TI SHKRUAN... AI PIKTURON

Kujto! Foljet ndryshojnë sipas vetave.

• **Në vend të pikave shkruaj si duhet foljen shkruaj:**

Unë lexoj dhe .....
Ti lexon dhe .....
Ai (Ajo) lexon dhe .....
Ne lexojmë dhe .....
Ju lexoni dhe .....
Ata (Ato) lexojnë dhe .....

1. Lidh me shigjetë:

Unë	luajmë
Ti	luani
Ai (Ajo)	vrapoj
Ne	vrapon
Ju	luajnë
Ata (Ato)	vrapon

2. Shkruaj si duhet foljet në kllapa.

Unë (dëgjon) ..... me vëmendje mësuesen.
Ti po (shkruaj) ..... detyrat.
Ne (këndoni) ..... një këngë në festival.
Ju po (vizatojnë) ..... një kalë.
Fëmijët (këndojmë)..... me zë të lartë.
Djali (vizatoj) ..... me lapsa me ngjyra.
Vajza po (shkruaj) ..... letër për shoqen.

3. Përgjigju me shkrim pyetjeve:

A po e lexon librin e ri? Po, unë .....
A po i mbaroni ju detyrat? Po, ne .....
A po i mësojnë ata vjershat? Po, ata .....
A po e dëgjon motra radion? Po, motra .....

Vjersha e pyllit

Fryn e fryn një fllad i lehtë
përmbi pyllin gjelbërosh...
Ajri i pastër më mbush gjoksin,
këngë e zogjve po më josh.

Ndaj vrapoj, vrapoj me gaz
përmes drurëve të lartë.
Nëpër gjethe nëpër degë
lëshon rrezet dielli i artë.

Unë vrapoj, vrapoj, vrapoj
nëpër shkurre, nëpër bar...
Ja, më duket fluturoj...
Krahë më japin zogjtë këngëtarë.

Sazan Goliku

Mëso fjalë të reja

më josh – më bën për vete.

Nënvizo vargjet ku shprehet:

- Ajri i pyllit të bën shumë mirë për shëndetin.
- Në pyll kënaqemi me këngën e zogjve.
- Në pyll është shumë bukur, kur rrezet e diellit futen mes gjetheve.
- Në pyll është shumë e shëndetshme të vraposh.

Po ti?

Trego për një shëtitje që ke bërë në pyll ose në një park me gjelbërim. Çka ke parë atje? Çka të pëlqen të bësh kur je atje?

Loli dhe trau i ekuilibrit

Loli u afrua te trau i ekuilibrit dhe e pa me vëmendje. Pastaj filloi të kruante kokën, ndonëse ajo nuk i hante fare. Trau filloi t'i dukej sikur ishte i hollë sa një fije peri.

– Hip, – i tha mjeshtri. – Ti Dik, mbaje nga shputat e para, sa ta kalojë një herë, pastaj lëre ta bëjë vetë.

Loli hipi mbi tra sikur po shkelte mbi vezë dhe menjëherë zbriti shumë serioz.

– Pse zbrite? – e pyeti mjeshtri.

Loli ia ktheu me një buzëqeshje të lehtë e të pafajshme:

– Mos u shqetësoni, mjeshtër, do të hipi përsëri. Ja sa ta përqafoj pak Nelin, se kushedi se çfarë më ndodh. Është i lartë trari.

– S'kam parë kurrë një ari të tillë kaq të përkëdhelur. Ti je i padisiplinuar. Hip menjëherë mbi tra! – e urdhëroi mjeshtri.

Loli hipi mbi tra dhe e kaloi duke u dridhur. Ai e shtrëngonte aq fort shputën e Dikut, sa ajo ishte skuqur dhe lagur nga djersa.

– Tani kaloje pa u mbajtur, – i dha zemër mjeshtri, që përpiqej me të gjitha mënyrat t'i nxirrte frikën Lolit.

Loli nuk e zgjati më, mori vrull dhe u ngjit në tra. Por, pas pesë hapave, ra si një trung mbi dyshek dhe bërtiti:

– Oh, këmba! Ndrydha këmbën! Oh... oh...!

Mjeshtri i mërzitur shkoi te qentë. Suloja ia tërhoqi nja dy herë këmbën Lolit dhe i tha të shkonte në dhomë e të shtrihej në kolltukun e gjerë. Ai doli çalë-çalë nga arena, me fytyrë të shtrembëruar nga dhimbja. Sapo mbylli perden, buzëqeshi me vete dhe tha me zë të lartë:

– Ua hodha edhe sot. Nesër duhet të shpik ndonjë gjë tjetër.

Por sapo mbaroi, dëgjoi zërin e papagallit që përsëriti me zë të lartë fjalët e tij. "Obobo! – mendoi i frikësuar, – tani do ta marrin vesh të gjithë!"

Gaqo Bushaka

Kupto tekstin

Përgjigju pyetjeve

1. Çfarë po bënin Diku dhe Loli:
   - ☐ po jepnin shfaqje;
   - ☐ po luanin;
   - ☐ po stërviteshin?
2. Cili është urdhri që i dha mjeshtri Lolit? Pse?
3. Çka ndodhi më pas me Lolin:
   - ☐ zbriti nga trau;
   - ☐ e kaloi traun;
   - ☐ u rrëzua?
4. Nga cilat fjalë të Lolit e kuptoni se ai është përtac dhe frikacak?
5. Nga se u tremb në fund Loli?

Mëso fjalë të reja

Ne themi që dikush është **i disiplinuar**, kur i zbaton të gjitha rregullat e caktuara. E kundërta është – **i padisiplinuar.**

Po ti?

- Pse na bëjnë për të qeshur veprimet e Lolit?
- Ke vepruar ndonjëherë si Loli? Trego një rast kur nuk ke bërë një detyrë që të ka dhënë mësuesja ose prindërit dhe ke sajuar diçka.

Nënvizo fjalitë që të bëjnë për të qeshur. Thuaj pse.

Plotëso dhe shkruaj

Loli hipi mbi tra sikur ..... .

Trau filloi t'i dukej sikur ishte i hollë ..... .

Por pas pesë hapave, ra ..... .

Ai doli ..... nga arena.

Lexo me zë të lartë

Lexoje bukur pjesën dhe me humor nga: "Oh, këmba....

MEDIA

Në cirk

Me siguri ti ke parë shfaqje cirku në televizor ose kur ke qenë vetë në cirk.

Çka të pëlqen më shumë nga shfaqjet e cirkut?

- numrat e akrobatëve ☐
- numrat e kafshëve ☐
- numrat e klounëve ☐
- numrat e shpejtësisë ☐

1. Përshkruaj një numër cirku. Zgjidh një kur:

a. je habitur
b. të ka ardhur për të qeshur
c. i ke mbyllur sytë nga frika

b.

a.

c.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Faqja shkencore e revistës për fëmijë

Bota e qiellit

Toka e parë nga Hëna



astronauti

Bota e ujit

palombari

peshqit duke shtegtuar

peshkaqeni

- Në cilat nga këto dy vende ka jetë?

Ndahuni në dy grupe.
Njëri grup fluturon me astroflluskë. Grupi tjetër noton nën det. Bëni një udhëtim imagjinar.

Vizatoni në një fletë të madhe vizatimi vendet ku do të shkoni. Ngjitni në fletore vizatimi figura të prera nga revista të ndryshme.

Mëso fjalë të reja

palombari - zhytës me një veshje të posaçme.
astroflluskë - mjet i rrumbullakët që shërben për të fluturuar lart në qiell.

TEKSTET JANË TË NDRYSHME

Ishte një ditë e ftohtë dimri. Fëmijët u veshën trashë. Ata u nisën me mësuesen për në mal. Kishin marrë edhe skitë me vete. Kur autobusi arriti në kamp...

Viu-viu fryn veriu,
nëpër xhama troket shiu
Viu-viu fryj, moj erë,
bjer, o borë e bardhë, bjer.

Cila është ajo kafshë,
me madhësinë e një arre,
që ngjit mure e shkëmbinj,
pa këmbë fare?

Kërmilli

Pesë fletore me kutia
Dhjetë fletore me vija
Një kuti me lapsa
me ngjyra
Dy goma
Tre lapsa të zinj
Një stilolaps me gomë
Një vizore trekëndore

Ditën e shtunë fëmijët e të gjitha shkollave të qytetit dhanë një shfaqje artistike, me rastin e 1 Qershorit. Shfaqja u zhvillua te salla e Pallatit të Kulturës.

Pati duartrokitje të shumta nga të pranishmit. Salla ishte mbushur plot me nxënës, mësues e prindër...

Na ishte njëherë një mbretëreshë shumë e mirë, por ajo kishte një brengë të madhe. Njëherë ajo shpoi pa dashje gishtin me gjilpërë dhe gjaku i ra mbi dëborë. "Ah, – mendoi, – sikur të kisha një vajzë të bardhë si bora, me buzë të kuqe si gjaku dhe me flokë të zinj si nata!" Në krye të nëntë muajve mbretëresha lindi një vajzë shumë të bukur. Ajo ia vuri emrin BORËBARDHË..

Gur, gur bëhet mur!

Detyrë

Dallo nga intonacioni i mësueses se cili prej teksteve është:

1. përrallë; 2. tregim; 3. listë; 4. njoftim; 5. gjëegjëzë; 6. fjalë e urtë; 7. vjershë.

UJI, AJRI, TOKA, ZJARRI

A të pëlqejnë librat enciklopedikë, që flasin për tokën dhe kozmosin? Pse të pëlqejnë?

Plotëso fjalitë me fjalët e duhura.

Ajri

Ajri është aq i fuqishëm, sa mund ..... në qiell zogj, aeroplanë, ...e tullumbace. Ai tund gjethet e pemëve, na fërshëllen në vesh dhe na ..... kapelën nga koka. ..... ne nuk jetojmë dot.

balona

e rrëmben

Pa ajër

të mbajë lart

Uji

Nëse do të mungonte uji, toka..... . Nuk do të kishte bimë, kafshë apo..... Të gjitha qeniet ..... do të vdisnin.

Pikat e ujit mund të bëhen ....., re, ..., lumenj dhe..... Edhe lotët tanë janë, gjithashtu, ...

borë

njerëz

dete

e gjalla

do të thahej

pikla uji

Zjarri

Uji na freskon, zjarri..... Nxehtësia e tij na kënaq..... Në kohët e lashta njerëzit nuk dinin..... Ata ndriçoheshin vetëm ..... dhe të hënës.

akull

me dritën e diellit

si ndizej zjarri

na ngroh

Toka

E ke nuhatur ndonjëherë erën....., kur sapo ka pushuar shiu? Po ngjyrën e saj e ke parë? Mund të jetë kafe, ...ose e zezë. Mbi tokë jetojmë ne ..... dhe miliona kafshë. Toka është e mbuluar edhe me bimë, të shumta, ... dhe ujë.

kur është ftohtë

e verdhë

me borë

njerëzit

e tokës së lagur

Keci me veshë të mëdhenj

1.

Omeri ishte djali i një trimi të madh që jetonte në bjeshkë. Ai u rrit më shpejt se moshatarët e tij. Kur u bë gjashtë vjeç, dukej sikur ishte dymbëdhjetë.

Një ditë Omeri iu lut nënës:

– Oj nënë, dua dhe unë ta kullot tufën e kecave në bjeshkë. Tani u rrita.

– Ti je ende i vogël, o bir, kurse bjeshka është e madhe. Kam frikë se tufa do të shpërndahet dhe kecat do të të humbasin.

– Jo, nënë, mos ki merak. Unë nuk do t'i heq sytë nga tufa.

2.

Omeri e çoi tufën në bjeshkë. Papritur një kec i përhimë, me veshë të mëdhenj, u shkëput nga tufa. Ai u largua duke kërcyer hop këtu e hop atje.

– O kuku! Ç'më gjeti! – u shqetësua Omeri. – Ky do të më turpërojë para nënës.

Ai vrapoi pas kecit. E ndoqi deri poshtë bjeshkës, nëpër kodra e lugina. Gjithë ditën vrapoi pas tij. Më në fund e kapi.

3.

Në mbrëmje zbriti poshtë me tufën dhe e futi atë në vathë.

– Si e kalove ditën?– e pyeti nëna.

– Mirë, nënë, po ai keci i përhimë më ka lodhur boll. Asnjë fije bari nuk ka kullotur. Mezi e futa në tufë.

– Ne nuk kemi kec të përhimë! – u çudit nëna.

– Po, moj nënë. A e di cili është? Ai keci me veshë të mëdhenj.

– Kecat i kanë veshët të vegjël, mor bir, – tha nëna.

– Eja ta shohësh, – iu lut Omeri.

Shkuan te vatha. Omeri ia tregoi me gisht.

– Qe ku është!

Nëna pa një lepur të madh, që rrinte strukur anës gardhit duke luajtur veshët.

– Po ky është lepur, mor bir! – thirri nëna. – Si munde ta zësh?! Të pastë nëna, kushedi sa je lodhur!

- Aspak, – tha Omeri.

Nëna u bind se Omeri ishte i fortë dhe trim, ashtu sikurse i ati, Muji.

Përshtatur nga *Cikli i Kreshnikëve*

Kupto tekstin

Mëso fjalë të reja

bjeshkë – mal i lartë ku ka vend për të kullotur bagëtinë.
kullot tufën – çoj bagëtinë, dele, dhi, keca, lopë etj., për të ngrënë dhe kujdesem për to.
vathë – vend i rrethuar me gardh ku rri bagëtia.
i përhimë – ngjyrë hiri.

Përgjigju pyetjeve

1. Kush ishte Omeri?
2. Ku jetonte ai?
3. Për çka iu lut Omeri nënës?
4. Çfarë meraku kishte nëna?
5. Cili u shkëput nga tufa?
6. Cili e kishte lodhur Omerin?
7. Pse u çudit nëna nga fjalët e Omerit?
8. Çka kishte kapur në të vërtetë Omeri?
9. A të vjen për të qeshur në fund të pjesës? Pse?

Veprimet e personazheve

1. Dallo veprimet që bëjnë personazhet dhe lidhi me pjesën.

Çfarë bën Omeri?

- në pjesën e parë
- në pjesën e dytë
- në pjesën e tretë

E fut kecin e përhimë në tufë.
I lutet nënës ta kullotë bagëtinë.
E ndjek pas kecin e përhimë.
I kundërshton fjalët e nënës që nuk do ta lejojë.
Lodhet shumë duke vrapuar.
I thotë nënës se është lodhur shumë.
E kap kecin e përhimë.
Ia tregon nënës kecin e përhimë.

Çfarë bën nëna e Omerit?

- në pjesën e parë
- në pjesën e dytë
- në pjesën e tretë

E lejon Omerin që ta kullotë bagëtinë.
Nuk beson tek Omeri.
E kundërshton Omerin për kecin.
E pyet a është i lodhur.
I thotë se nuk kanë kec të përhimë.
Shkon te vatha bashkë me Omerin.
I thotë Omerit se ai që ka zënë është lepur.
Mendon se Omeri është i fortë dhe trim si i ati, Muji.

2. Plotëso.

a. Cilat janë disa nga cilësitë e Omerit? ....., ..., ...
b. Omeri e ngatërroi kecin me ..... .
c. Keci i Omerit i kishte veshët ..... .
ç. Kecat i kanë veshët ..... .
d. Omeri i ngjante ..... .

3. Shkruaj tri fjali të plota për Omerin.

.....

.....

.....

LEXOJMË

Guri i Skënderbeut

Skënderbeu porositi te mjeshtër Medari një shpatë të re. Pas një jave ai shkoi ta merrte te farka.

– Puna e mbarë, mjeshtër! – e përshëndeti Skënderbeu.

– Mbarë paç, kryezot! – iu përgjigj Medari.

– Erdha ta marr shpatën që e porosita. E ke gati? – e pyeti Skënderbeu.

– Po, shpata pret të zotin, Gjergj Kastriotin, Princin e Krujës dhe të Matit.

– I keni plotësuar të gjitha porositë e mia?

– Po, kryezot, të gjitha. Kurrë në jetën time nuk kam farkëtuar shpatë kaq të madhe dhe kaq të rëndë, – i tha farkëtari.

– Unë dua të di, a është vërtet e fortë? – e pyeti Skënderbeu.

– Më e fortë s'ka si bëhet, – ia ktheu mjeshtri.

– Tani do ta provojmë, – i tha Skënderbeu. – Eja me mua!

Skënderbeu doli nga farka me shpatën në dorë. Pas tij doli mjeshtër Medari, si dhe luftëtarët që e shoqëronin. Jashtë farkës ishte një shkëmb shumë i madh. Skënderbeu filloi ta godiste shkëmbin me shpatë. Shkëmbi u bë vija-vija, ndërsa shpata nuk pësoi gjë.

– Të lumtë mjeshtër! – i tha Skënderbeu farkëtarit. Unë shpatën nuk e dua si stoli, po për të luftuar.

Tani farka nuk është më, por shkëmbi është ende me vijat e prera.

Këtë shkëmb krutanët e quajnë Guri i Prerë ose Guri i Skënderbeut.

Naum Prifti

Kupto tekstin

Mëso fjalë të reja

farkë – punishte ku ndreqen sende prej metali, si sëpata, vegla bujqësore etj.
kryezot – princ a sundimtar i një vendi.
farkëtar – ai që punon në farkë.
krutanët – banorët e Krujës.
stoli – send zbukurimi.

Përgjigju pyetjeve

1. Çfarë porositi Skënderbeu te mjeshtër Medari?
2. Kur shkoi përsëri ai atje?
3. Çfarë i tha atij mjeshtër Medari?
4. Si e provoi Skënderbeu shpatën?
5. Ku është shkëmbi që goditi Skënderbeu?
6. Si quhet ai?

MEDIA

Mësojmë për Skënderbeun - faqja shkencore

Skënderbeu ka lindur më shumë se 600 vjet më parë, në vitin 1405. Ai është nga udhëheqësit më të shquar shqiptarë. Skënderbeu luftoi 25 vjet rresht kundër pushtuesve osmanë. Gjatë kësaj kohe, ai u bë shumë i njohur në të gjithë Evropën. Një nga ngjarjet më të bukura në historinë e asaj kohe është kur Skënderbeu erdhi për herë të parë në Krujë. I gjithë populli doli ta priste.

Krujë, o qytet i bekuar!
Prite, prite Skënderbenë,
Po vjen si pëllumb i shkruar,
Të shpëtojë mëmëdhenë.

N.Frashëri

1. Pas leximit të mësueses plotëso:

- Skënderbeu ka lindur në vitin .....
- Skënderbeu luftoi ..... vjet rresht kundër .....
- Skënderbeu u bë i njohur në .....
- Qyteti i parë që e priti Skënderbeun ishte .....

2. Shiko figurat dhe fol për to.

• Për Skënderbeun tregohen histori të ndryshme.
A di edhe ti ndonjë? Tregoje atë në klasë.

3. Lidh me shigjetë.

Skënderbeu ishte	kundër pushtuesve osmanë.
Ai ka luftuar	shumë i shpejtë.
Shpata e tij ishte	ishte shqiponja me dy krerë.
Përkrenarja e tij ishte	një komandant i shquar.
Kali i tij ishte	e mprehtë dhe e rëndë.
Në flamurin e Skënderbeut	shumë e madhe.

Festa e fëmijëve - Revista

1 Qershori është festa më e bukur. Ajo është festa e fëmijëve. Bota e të rriturve bëhet prej fëmijëve më e mirë dhe më e gëzueshme. Kjo është një ditë që lajmëron se po vjen vera. Qielli është i kaltër dhe me re të bardha, të cilat fëmijët kanë qejf t'i prekin me dorë. Ata bëjnë balona me bisht të gjatë. Pastaj fryjnë tullumbacet ngjyra-ngjyra dhe i lëshojnë lart. Era e lehtë dhe e freskët i ngre në qiellin e kthjellët. Fëmijët i ndjekin me sy, derisa nuk i shohin dot më. Me siguri ato ulen mbi retë e bardha qumështore.

Edhe Era me shoqet dhe shokët e klasës vendosën të përgatitin dy balona shumë të mëdha. Në secilën prej tyre ata shkruan dëshirat dhe premtimet.

Kupto tekstin



Përgjigju pyetjeve

1. Çfarë është 1 Qershori?
2. Si është moti në qershor?
3. Çfarë lajmëron ky muaj?
4. Si e festojnë fëmijët 1 Qershorin?

Mjetet që duhen për të përgatitur një balonë:

- tabakë letre
- shirita letrash me ngjyra
- kallama ose shkopinj të hollë
- ngjitës
- penel dhe bojëra uji (ose lapsa me ngjyra)
- spango

Provoni së bashku me mësuesen/in ose prindërit që të bëni një balonë.

Jemi vëllezër të një botë - Revista

Lexo vjershat që mban pëllumbi në sqep.

JEMI TË LUMTUR

Jemi të lumtur,
me barin dhe rërën.
Të lumtur,
me ajrin dhe tokën.
Na lini të jemi të lumtur...

(Pablo Neruda)

ÇDO ZOG KA KËNGËN E TIJ

Çdo zog ka këngën e tij,
çdo popull gjuhën e tij.
Por njëlloj,
së bashku këndojmë.
Luftë - Jo!
Paqe - Po!

(Xhani Rodari)

Çfarë tregojnë vjershat? Recitoji bukur ato.

Pikturo një pëllumb dhe shkruaj diçka në shiritin që ai mban në sqepin e tij.

Në botë janë bërë dhe bëhen
shumë luftëra. Ka njerëz
që nuk e duan njëri-tjetrin.
Ka shtete që luftojnë
kundër njëri-tjetrit.
A është gjë e mirë kjo?

Shikoji fëmijët
në fotografi.
Ngjyra e lëkurës
së tyre është
e ndryshme.
Ata e duan njëri-tjetrin.
Ku duket kjo?

MEDIA

NË CILIN VEND TË BOTËS JETOJ UNË? DOKUMENTARI SHKENCOR

1. Vendos në vendin e duhur fjalët:

shqiptar | shqiptarë | evropian | jetoj | njëri-tjetrin

Amerikë | Maqedoninë | të lumtur | Gadishulli | të ndryshëm

njerëz | i botës | Ballkanit

a. Unë jam..... . Unë ..... në Kosovë. Kosova gjendet në gadishullin e .... i Ballkanit është në Evropë. Pra, unë jam ..... .

b. Vëllezërit e mi..... jetojnë në Shqipëri dhe në .....e Veriut.
Ka dhe shumë shqiptarë që jetojnë në vende të ndryshme, si në Evropë dhe .....

c. Ne jetojmë në një botë ku ka shumë ..... . Njerëzit janë .....
Edhe pse jemi të ndryshëm, ne duhet ta duam ..... .
Vetëm kështu do të jetojmë..... .

2. Shiko fëmijët në fotografi. Çfarë po tregojnë ata?

3. Shkruaj fjali sipas këtij shembulli:

Cilët jetojnë në AFRIKË?	Në Afrikë jetojnë afrikanët.
Cilët jetojnë në AMERIKË?	..... .
Cilët jetojnë në EVROPË?	..... .
Cilët jetojnë në AUSTRALI?	..... .
Cilët jetojnë në AZI?	..... .

A MUND TË KETË QYTET TË FËMIJËVE? - FILMI

Ju tashmë jeni bërë miq me personazhin tuaj të dashur, Pinokun. Njëherë ai u largua nga shtëpia dhe shkoi në qytetin e fëmijëve. Atje fëmijët luanin nga mëngjesi deri në darkë. Ata bënin çfarë u vinte në mendje. Atje nuk kishte të rritur që t'i ndalonin për ndonjë gjë.

Çdo fëmijë e ëndërron një qytet të tillë. Po a mund të ekzistojë ai?

Sigurisht që jo. Qyteti i Pinokut është vetëm në përrallë. Në jetë fëmijët nuk mund të jetojnë vetë, pa ndihmën e të rriturve. Të rriturit punojnë shumë që fëmijët të ushqehen, të vishen, të kenë libra dhe lodra.

Për të plotësuar ëndrrat e fëmijëve, të rriturit kanë ndërtuar Qytetin e Lojërave. Ai quhet Diznei Lend *(Disney Land)*. Është një vend i mrekullueshëm.

Ku i dihet, mund ta shihni dhe ju!



Diskutoni së bashku: Si e ëndërroni ju Qytetin e Fëmijëve?
Si e imagjinoni ju Qytetin e Lojërave?

Ardhja e verës

Kur është pranverë moti ndryshon shpesh. Është herë ftohtë e herë ngrohtë. Qielli përshkohet vazhdimisht nga re të mëdha, të bardha e gri. Herë pas here retë bashkohen në një të vetme, të madhe në ngjyrë të errët. Pastaj moti ndryshon dhe ne nuk e kuptojmë, se vera futet pa u ndier në shtëpinë tonë.

Retë bëjnë përpjekjen e tyre të fundit. Ato lëshojnë shi për një kohë të shkurtër. Dhe kur e shohin se nuk munden më, tërhiqen.

Të nesërmen në mëngjes dielli del në qiellin e kaltër të verës, ku nuk ka asnjë re të vogël. Sa ditë e bukur dhe e qetë!

Dhe pastaj në mesditë, njerëzit futen në shtëpi. Rrugët zbrazen nga trafiku e zhurmat. Sa qetësi nën diellin e nxehtë e të zjarrtë!

Alberto Moravia

KUPTO TEKSTIN

Plotëso dhe shkruaj

1. Moti në pranverë ..... shpesh.
2. Herë pas here retë bashkohen në..... .
3. Ne nuk e kuptojmë se vera ..... në shtëpinë tonë.
4. Retë lëshojnë ..... për një kohë të shkurtër.
5. Dielli del në qiellin ..... të verës.

Po ti?

1. A të pëlqen stina e verës? Pse?
2. Cila pjesë e ditës të pëlqen më shumë në verë: mëngjesi, dreka apo darka? Pse?
3. Pse në mesditë rrugët zbrazen në verë?



Detyrë

Ngjyros qiellin dhe detin në një ditë vere.

TË GJITHË ME PUSHIME

Plotësoji figurat me fjalë.

një panoramë

kështjellë rëre

të zhytem

te një ishull

një byzylyk

boçe pishe

delfin

Besi thotë: – Nga maja do të shoh .... shumë të bukur.

Hava thotë: – Do të mësoj..... .

Blerta thotë: - Do të mbledh ..... .

Lisi thotë: – Në breg do të bëj një..... .

Arbi thotë: – Mbase do të shoh një..... .

Vesa thotë: – Do të iki me anije..... .

Era thotë: – Me guaskat do të bëj..... .

Më pëlqen vera, sepse...
Fillojnë pushimet dhe nuk ka mësime dhe detyra.
Mund të hash akullore pa u ftohur.
Sa herë që ke vapë, hyn drejt e në det.
Dita është e gjatë, pasi dielli perëndon shumë më vonë sesa në stinët e tjera.
.....
.....
.....
.....

Nuk më pëlqen vera, sepse...
Ndonjëherë bëhet shumë vapë.
Ka shumë mushkonja.
Mund të digjem nga rrezet e diellit, nëse nuk përdor krem mbrojtës e rri jashtë çadrës në orët e drekës.
.....
.....
.....

Mysafirët

Mirë se na erdhe teze,
porsi hëna me rreze.

Mirë se na erdhe gjyshe,
gushë - dallëndyshe!

Mirë se na erdhe dajë,
si ylli në majë!

Mirë se na erdhe kushërirë,
porsi ëmbëlsirë!

Mirë se na erdhe hallë,
mysafire e rrallë!

Sa herë e hapni këtë derë,
dimri bëhet verë.

(Rifat Kukaj)

Kupto tekstin

Plotëso dhe shkruaj

1. Cilët janë mysafirët që vijnë në shtëpi?
2. Me cilat fjalë i lavdëron ata poeti?

Teze	*diell me rreze*
Gjyshe	.....
Dajë	.....
Kushërirë	.....
Hallë	.....

3. Mysafirët sjellin gëzim në shtëpi.
   Në cilin varg duket kjo?

4.

Hallë	motra e babait
Dajë	.....
Teze	.....
Xhaxha	.....
Gjyshe	.....
	ose .....
Gjysh	.....
	ose .....

GJUHA SHQIPE 2